



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 21/41 prot.

Tiranë më, 02.05.2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. LORENC KRISTO PANGANIKA

Nr. 28, datë 02.05.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Erjana Pjetri
Ersa Karaj
Klevis Dhigoi**

**Kryesuese
Relatore
Anëtar**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Lediana Azemaj, më datë 02.05.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Lorenc Kristo Panganika**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes Ersë Karaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Lorenc Panganika, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Lorenc Kristo Panganika është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupa e Vlerësimi të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, Z. Lorenc Kristo Panganika, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr.** datë 18.04.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit e përbërë nga: znj. Erjana Pjetri (Kryesuese), znj. Ersë Karaj (Relatore) dhe z. Klevis Dhigoi (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin Nr.** prot., datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika.
6. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, ku i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse

është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në rrugë elektronike më datë 20.04.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Panganika, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - Formularin e deklarimit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresën Nr. ** Prot., datë 19.04.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
 - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr.** Prot., datë 19.04.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Formularin e Kontrollit të Figurës me shkresë përcjellëse Nr.** Prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit,

Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;

- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI Nr.15, datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

13. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklarave për të justifikuar deklaratimet;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Trupa e Vlerësimit më datë 15.04.2024, pasi dëgjoji relatorin, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Panganika, me Vendimin Nr.***, datë 15.04.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika.
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët: vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe të paraqesë shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Lorenc Panganika, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 19.04.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.
17. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.
18. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 02.05.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

19. Subjekti i vlerësimi Lorenc Kristo Panganika ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
20. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatores.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
22. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Lorenc Panganika ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 01.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi 07, viti 2023.

23. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32, nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

26. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27. Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- Deklaratat e interesave private për të gjithë periudhën që ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

28. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

29. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

29.1 Lorenc Paganika është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe ka

dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2003
- Periodike/Vjetore 2004
- Pas largimit nga funksioni 2005
- Para fillimit të detyrës 2013
- Periodike/Vjetore 2013
- Pas largimit nga funksioni 2014
- Periodike/Vjetore 2014
- Periodike/Vjetore 2015
- Pas largimit nga funksioni 2016
- Para fillimit të detyrës 2017
- Periodike/Vjetore 2017
- Periodike/Vjetore 2018
- Periodike/Vjetore 2019
- Periodike/Vjetore 2020
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022

29.2ILDKPKI-ja në përputhje me Ligjin Nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm Nr. *** Prot., datë 06.11.2023, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Paganika, ku është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i remë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

**DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, LORENC KRISTO
PANGANIKA**

I. PASURI TË PALUAJTSHME

1. **Apartament banimi me sipërfaqe 60 m²**, adresa Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, rruga “Thoma Kalefi” pall. nr. **, hyrja 2**, ap. nr. **.

Burimi i krijimit: Dhuruar nga babai.

Pjesa takuese: 100%

1.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacionin:

- Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr.***, datë 14.02.2017, nga ZVRPP Elbasan.
- Kontratë dhurimi nr. ***/***/*, datë 02.02.2017.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 16.04.2002, nga ZVRPP Elbasan, në emër të K.P.
- Kontratë shitje nr. ***/***, datë 10.04.2002.

HETIMI ADMINISTRATIV

1.2 Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u kanë kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Regjistrat Notal, FSHU, 14 Shoqërive Rajonale Ujësjetllës – Kanalizime, institucioneve bankare dhe jo-bankare, si dhe u janë drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

1.3 **ASHK Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.07.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të Lorenc Panganika.

1.4 **FSHU**, me shkresën nr. *** prot., datë 19.05.2023, referuar sistemit të faturimit, konfirmon se në emër të Lorenc Panganika ka një kontratë furnizimi nr. EL****, në instancën Elbasan.

1.5 **Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës - Kanalizime Elbasan**, me shkresën nr. ** prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Lorenc Panganika ka një kontratë furnizim nr. ***, me vendndodhje lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, Rruga “Thoma Kalefi”.

1.6 **14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetllës - Kanalizime**, me shkresat nr. ** - ** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

1.7 Trupa e Vlerësimit vëren se:

- Kontrata e furnizimit e lidhur me FSHU me nr. EL**** në instancën Elbasan, rezulton e njëjtë me librezën e vënë në dispozicion nga subjekti i vlerësimit si dokumentacion shoqërues.
- Sipas dokumentacionit shoqërues të përcjellë nga subjekti i vlerësimit, konfirmohen të dhënat në librezën e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan.

1.8 Në lidhje me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit në vlerën 1.900.000 lekë dhe dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e babait deri në vitin 2002, subjekti paraqiti shpjegime në procesverbalin e datës 12.09.2023, ku sqaron se apartamenti është blerë nga të ardhurat ndër vite të familjarëve të tij, K. Panganika, G.P., K.P. Babai është marrë me veprimtarinë e shitjes se makinave në vitet 1992 deri 1995 dhe vëllai ka ushtruar aktivitetin e shërbimit taksi me fugon në vitet 1993 deri 1997. Fillimisht në këtë apartament ka banuar vëllai G.P. me familjen e tij, i cili pas disa viteve, së bashku me familjen e tij banojnë në apartamentin e prindërve të bashkëshortes së tij E.P (të cilët

kanë ndërruar jetë). Nga viti 2012, në atë apartament banon subjekti me familjen e tij. Për këtë arsye, në marrëveshje dhe mirëkuptim, familjarët e tij, babai dhe vëllai, u dakordësuan që ky apartament t'i dhurohej subjektit. Për mobilimin e shtëpisë, nuk ka kryer shpenzime, pasi apartamenti ka qenë i mobiluar, kur i është dhuruar.

1.9 Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, apartamenti është nr. 5 dhe jo nr. 3, siç e ka deklaruar, pasi është një lapsus. Deklaron me përgjegjësi se është i njëjti apartament.

1.10 Pasi mori në shqyrtim edhe dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga subjekti më datë 12.09.2023, pranë ILDKPKI-së, konkretisht:

- Certifikatë familjare nga Njësia Administrative Elbasan **, në emër të kryefamiljarit Lorenc Panganika, me status beqar, në datën 10.04.2002.
- Certifikatë familjare, nga Njësia Administrative Elbasan **, familjes Panganika, ku G.P. ka bërë ndarje familjare, në datë 10.02.2010.
- Kontratë dhurimi nr. ***/***/**, datë 02.02.2017, me palë dhuruese K.P dhe K.P., palë pranuese Lorenc Panganika.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.06.2023, nga ISSH, që konfirmon se K.P ka përfituar pension ushtarak të parakohshëm për periudhën 01.01.1999 - 01.04.2005.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.06.2023, nga ISSH, bashkëlidhur dosja e pensionit të plotë e shtetasit K.P.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.06.2023, nga ISSH, që konfirmon se K.P. ka përfituar pension pleqërie për periudhën 01.05.2000 - Mars 2023.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 13.06.2023, nga ISSH, bashkëlidhur dosja e pensionit të plotë e shtetases K.P..
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme në emër të K.P., ku ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë D.SH. Parësor, për periudhën 1 Janar 1994 - Prill 2000.
- Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni nr. *** prot., datë 13.06.2023, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan, për shtetasin G.P..
- Vërtetim vjetërsie për personat fizik dt. 13.06.2023, në emër të G.P., i punësuar pranë PF "E.P". Për periudhën 1992 - 1993 nuk ka emër në indeksin e personave fizik Elbasan.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dt. 13.06.2023, në emër të G.P., ku ka realizuar të ardhura nga punësimi pranë shoqërisë "***".
- Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.08.2023, nga Bashkia Elbasan, drejtuar G.P., mbi veprimtarinë e ushtruar nga K.P, për periudhën 1992- 1997, në qytetin e Elbasanit.

1.11 Trupa e Vlerësimit vëren se:

1.12 Pala dhuruese K.P ka të regjistruar apartament me sip. 60 m², me nr. pasurie ****, në adresën Lagjja "Brigada 17 Sulmuese" Elbasan, p. **, shk. **, kati i **, ap. **. Dhuruesi K.P dhe bashkëshortja K.P. i dhurojnë pasurinë palës pranuese Lorenc Panganika, pa kundër shpërblim.

1.13 Pasuria nr. *** në ZK8522, me sipërfaqe 60 m² me adresë "Brigada 17 Sulmuese", rezulton e regjistruar në emër të Lorenc Panganika. *Në rubrikën komente nga regjistruesi:*

Lëshohet sipas kontratës së dhurimit nr. ****, datë 02.02.2017.

1.14 Sipas librezës së punës dhe modularit për efekt pensioni, shtetasi K.P ka kryer 26 vjet punë e 2 muaj e 29 ditë.

1.15 Nga kërkimi në arkivin e Drejtorisë së Tatimeve Taksave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, nuk disponohet dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e ushtruar nga K.P, për periudhën 1992- 1997, në qytetin e Elbasanit.

1.16 **Shtetasi G.P.:**

- Për periudhën 1992 – 1993, nuk ka emër në indeksin e personave fizik Elbasan.
- Për periudhën 01.12.1994 - 30.09.1995, ka qenë person fizik.
- Për periudhën 1996 – 1998, nuk ka derdhje kontributesh.
- Për periudhën Nëntor 2000 - Mars 2002 ka derdhje kontributesh për të ardhurat nga punësimi pranë shoqërisë “***”.

1.17 Nga hetimi administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaramit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- ✓ **Apartamenti me sipërfaqe 60 m², në Rr. “Thoma Kalefi”, Elbasan, është përfituar me kontratë dhurimi nga prindërit e subjektit në vitin 2017. Ky apartament është blerë nga babai në vitin 2002, me vlerë 1.900.000 lekë.**
- ✓ **Apartamenti i është dhuruar subjektit nga prindërit e tij në vitin 2017.**
- ✓ **ASHK, nuk konfirmon apartamentin të regjistruar në emër të subjektit.**

2. **Apartament 68 m²**, ndodhur në adresën adresa lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, rruga “Thoma Kalefi” pall. nr. **, hyrja *, ap. nr. **.

Burimi i krijimit: Përfituar nga privatizimi në vitin 1991 (si pjesëtar familje).

Vlera: 5.000 lekë. *Vlera e përafërt në atë kohë.*

Pjesa takuese: ¼

2.1 Subjekti ka bashkëlidhur vërtetim datë 08.03.2022, nga ASHK Drejtoria Vendore Elbasan.

HETIMI ADMINISTRATIV

2.2 ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. ** prot., datë 04.07.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka në bashkëpronësi pasurinë nr. **, vol.**, fq. *, ZK 8522, regjistër **, faqe ***. *Bashkëlidhur:*

- Praktika e privatizimit.
- Formular nr. 2 datë 22.06.1993, në emër të K.P për apartamentin 2+1.
- Përbërja familjare, në gjendjen civile dt. 01.12.1992.
- Planimetria e apartamentit në emër të K.P, në lagjen “Brigada e 17 Sulmuese”, p. **, AP **.

2.3 Nga administrimi i Vërtetimit datë 08.03.2022 dhe praktikës me shkresë nr. *** prot., datë 04.07.2023, nga ASHK Drejtoria Vendore Elbasan, Trupa e Vlerësimit vëren se:

- Në emër të shtetasit Lorenc Paganika figuron i regjistruar në vol.**, fq. **, ZK 8522, në regjistrin hipotekor **, me numër rendor ***, datë 14.07.1993, pasuri e paluajtshme e llojit apartament, me sip. 68 m², me adresë lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, p. **, ap. **, Elbasan.
- Këtë pasuri, subjekti i vlerësimit e ka në bashkëpronësi me 1/4 pjesë takuese, me shtetasit K.K (babai), K.K (bashkëshortja e babait) dhe G.P. (vëllai).
- Apartamenti me sip. 68 m², lagjja. “Brigada 17 Sulmuese”, Rruga “Thoma Kalefi”, Elbasan, është përfituar me kontratë privatizimi në vitin 1993, në vlerën 7.592 lekë.

2.4 Në Proces-verbalin e datës 12.09.2023 pranë ILDKPKI-së, subjekti paraqiti shpjegime, ku sqaroi se në bazë të dokumentacionit të paraqitur, apartamenti rezulton me nr. 6 dhe jo nr. 4 që ai ka deklaruar, pra është një lapsus. Deklaron me përgjegjësi se është i njëjti apartament, duke bashkëlidhur praktikën e privatizimit, vërtetimin nga dokumenti hipotekor, nga ZVRPP Elbasan, të pasurisë nr. ***, në ZK8522, me sip. 68 m² dhe adresë lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, si dhe hartën treguese.

2.5 Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet dhe korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe Trupat e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijien e ASHK Elbasan.**

3. **Prenotim Apartament dhe Post Parkimi (garazh)**, Tiranë (tregu elektrik), nuk është aplikuar për regjistrim (fazë ndërtimi). Kontratë nr. Rep. *** dhe nr. Kol. ***, datë 29.09.2022, nëpërmjet shoqërisë “A** B** shpk”, si palë shitëse dhe Lorenc Paganika si palë blerëse. Në kontratë përfshihet apartamenti dhe një vend parkimi (garazh). Sipërfaqja totale e apartamentit 134.6 m² dhe sipërfaqja neto 120 m² dhe sipërfaqja totale e garazhit 10 m².

Vlera: 13.000.000 lekë (për t’u paguar në tre vite, në çmim përfshihen të dyja pasuritë)

Shlyer: 2.000.000 lekë

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit

Pjesa në %: 100 %.

Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin si vijon:

- Kontratë sipërmarrje nr. *****, datë 06.05.2022.
- Kontrata të tjera nr. *****, datë 26.09.2022, Amendim “Kontratë Sipërmarrje nr. *****, datë 06.05.2022”, me sipërmarrës shoqëria L*** dhe porositës shoqëria A** B** shpk.
- Kontratë premtim shitje nr. ***/***, datë 29.09.2022.
- Njoftim Debitimit, datë 14.10.2022, në Raiffeisen Bank, nga llogaria e Lorenc Paganika,

me përfitues A** B** shpk, në shumën 2.000.000 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

3.1 **Drejtoria Vendore e ASHK** Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Jug, Tirana Veri, Zonat e Stimuluara, me shkresën nr. *** prot., datë 04.07.2023, nuk konfirmojnë pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

3.2 Trupa e vlerësimit, kreu verifikimet dhe analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit dhe shpjegimet e tij me shkrim sipas procesverbalit datë 12.09.2023, pranë ILDKPKI-së, ku konkretisht vëren se:

3.3 Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *****, datë 06.05.2022, çmimi i apartamentit nr. 6, (3+1), me sipërfaqe totale 134,6 m², është 168.250 euro. Palët nënshkruajnë këtë kontratë dhe synojnë të likuidojnë detyrimet e lindura dhe ende të pashlyera nga sipërmarrësi dhe marrëdhënia kontraktuale për Kontratën e Furnizimit nr. *****, datë 29.10.2021, me objekt “Furnizim me Beton”. Palët kanë përcaktuar mënyren likuidimit të vlerës 168.250 euro, në katër këste.

3.4 Sipërmarrësi shoqëria L*** dhe porositësi shoqëria A** B** shpk, kanë nënshkruar një Amendim “Kontratë sipërmarrje nr. *****, datë 06.05.2022”, ku kërkuan që:

- *Objektit të kontratës t'i shtohet dhe një pasuri tjetër e paluajtshme, një post parkimi, nr. provizor 23, kati -2.*
- *Çmimi për m², i dakordësuar midis palëve, nga 1.250 euro për m², në total 168.250 euro të bëhet 120.000 euro për apartamentin dhe për post parkimin, ku apartamenti ka çmimin 107.000 euro dhe post parkimi 13.000 euro.*

3.5 Pala që ka porositur apartamentin, shoqëria “A** B** shpk”, ka shlyer totalisht çmimin 120.000 euro, ndërsa pala sipërmarrëse, shoqëria “L*** shpk”, konfirmon të drejtën që pala porositëse të ketë të drejtë të tjetërsojë pasurinë në favor të palëve të treta.

3.6 Më datë 29.06.2022, subjekti i vlerësimit Lorenc Panganika, ka nënshkruar një kontratë premtim shitje nr. ***/***, me palë premtuese shitëse “A** B**” shpk, për apartamentit nr. 6 (3+1) në katin e dytë, me sipërfaqe totale 134.6 m², nga e cila 120 m² sipërfaqe neto dhe 1 post parkimi provizor nr. 23, kati -2, me çmim shitje në vlerën 13.000.000 lekë. Referuar kësaj kontrate, blerësi do të shlyejë brenda një afati 3 vjeçar çmimin e apartamentit, me këste që do të dakordësohen nëpërmjet palëve, nga llogaria e palës blerëse në llogarinë e palës shitëse. Pala blerëse do të realizojë personalisht punimet e rifiniturave të brendshme.

3.7 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari page, ku në datën 14.10.2022 është debituar vlera 2.000.000 lekë me përfitues A** B** shpk me përshkrimin “Kalim pjesor për blerje apartamenti nr.6, post parkimi, sipas kontratës nr. ***/***, datë 29.09.2022”.

- 3.8 I pyetur në lidhje me ndryshimin e çmimit të apartamentit dhe shtimin më pas të një aseti tjetër Post Parkimi (garazh) sipas kontratës ndërmjet shoqërisë “A** B** shpk” dhe shoqërisë “L***”, në proces verbalin e datës 12.09.2023 pranë ILDKPKI, subjekti është shprehur se nuk mund të japë dot shpjegime, pasi janë marrëveshje ndërmjet shoqërive. Nga subjekti është negociuar vetëm me Shoqërinë “A** B** shpk”, në kohën e lidhjes së kontratës midis palëve. Sqaroi se, në kontratën nr. ***/*** kol, datë 29.09.2022, në germën “a”, thuhet se, “...pasuritë objekt i kësaj kontratë ndodhen aktualisht në ndërtim dhe do t’i shiten palës blerëse pa rifiniturat e brendshme”.
- 3.9 Mos-pasqyrimi i detyrimit financiar kundrejt kësaj shoqërie në seksionin e detyrimeve financiare, është bërë nga subjekti pa dashje. Sipas subjektit, detyrimi që i mbetet shoqërisë del qartë, pasi është cituar çmimi i blerjes prej 13.000.000 lekë për të dy asetet (apartament dhe garazh) dhe është bërë shlyerja vetëm e një kësti prej 2.000.000 lekë dhe detyrimi në kohën e dorëzimit të deklaratës është 11.000.000 lekë.
- 3.10 Subjekti deklaroi se burimi financiar i shumës 2.000.000 lekë, paguar si kësht blerje, është nga të ardhurat dhe kursimet në vite nga paga e tij dhe bashkëshortes, interesat e bonove dhe obligacioneve të thesarit (trajtuar tek të ardhurat). Subjekti paraqiti:
- 3.11 Deklaratë nr. ** prot., datë 02.03.2023, nga shoqëria A** B** shpk, që deklaroi se midis shoqërisë dhe Lorenc Panganika është lidhur kontratë premtim shitje, për shitje pasuri të paluajtshme nr. ***/***, datë 29.09.2022, për pasurinë apartament + post parkimi të ndodhur në Tiranë në vlerën 13.000.000 lekë. Shtetasi Lorenc Panganika deri në datën 28.02.2023, ka likuiduar në favor të shoqërisë, vlerën 2.000.000 lekë dhe ka një detyrim financiar në shumën 11.000.000 lekë.
- 3.12 Deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.06.2023, me deklarues shoqëria “A** B*** shpk” me administrator, A. SH, që konfirmon plotësisht përmbajtjen e deklaratës nr. ** prot., datë 02.03.2023, të bashkëlidhur.
- 3.13 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet në procesverbal, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmblodhur rezulton se:

*Apartamenti me sip. 134.6 m² dhe 1 post parkimi në Tiranë, në fazë ndërtimi, me vlerë 13.000.000 lekë, është përfituar me kontratë sipërmarrje me shoqërinë “A** B***” shpk., në dt. 29.09.2022. Është paguar kësti i parë 2.000.000 leke në Tetor të vitit 2022, me burim kurse familjare ndër vite dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë është 11.000.000 lekë. Fillimisht apartamenti është porositur nga shoqëria “A** B***” shpk tek shoqëria “L***” shpk, në Maj 2022, me çmim 168.250 Euro, i cili do paguhej pjesërisht me klering. Në datë 26.09.2022, dy shoqëritë kanë bërë amendim kontratë porosie, sipas së cilës çmimi i apartamentit bëhet 120.000 Euro, ku përfshihet edhe 1 post parkimi. Referuar kontratës premtim shitje nr. ***/***, datë 29.09.2022, pasuritë i shiten palës blerëse pa rifiniturat e brendshme.*

- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me kontratat e paraqitura, pagesën e kryer nëpërmjet Raiffesien Bank dhe detyrimin e mbetur në shumën 11.000.000 lekë, ndaj shoqërisë “A** B**” shpk.
- ✓ Burimi i pagesës së kështit të parë trajtuar tek të ardhurat.

4. **Prenotim 2 (dy) poste parkimi (garazh)**, nuk është aplikuar për regjistrim (fazë ndërtimi). Kontratë nr. Rep. *** dhe nr. Kol. ***, datë 13.10.2021, nëpërmjet shoqërisë “D**** shpk” si palë shitëse dhe Lorenc Panganika si palë blerëse. Garazhe nr. 44 dhe 45 (vende parkimi), kati -1 sipërfaqe totale 32.27 m² (e përafërt). Vendndodhja në Lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, Elbasan.
Vlera 16.000 euro.
Shlyer: 16.000 euro.
Pjesa takuese: 100%.

4.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë sipërmarrje (për prenotim garazhe) nr. *****, datë 13.10.2021.
- Nxjerrje llogari bankare ne BKT, në emër të Lorenc Panganika.

HETIMI ADMINISTRATIV

- 4.2 Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *****, datë 13.10.2021, porositi Lorenc Panganika i ka prenotuar shoqërisë sipërmarrëse “D****” shpk, 2 (dy) garazhe, kundrejt vlerës 16.000 euro.
- 4.3 Shoqëria “D****” shpk, e ka përfutur këtë pasuri me kontratë premtim shitje nr. *****, datë 27.01.2021, me shoqërinë “A****” shpk.
- 4.4 Çmimi i dy garazheve është në vlerën 16.000 euro, ku një garazh është në shumën 8.000 euro, në objektin që po ndërtohet nga shoqëria. Në kontratë është përcaktuar se shlyerja e shumës 16.000 euro do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i saj.
- 4.5 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrjen e llogarisë bankare në monedhën euro të Lorenc Panganika, ku konstatohet se në datën 29.10.2021 është transferuar vlera 16.000 euro.
- 4.6 **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.07.2023, nuk i konfirmon pasuritë e mësipërme të regjistruar në emër të Lorenc Panganika.
- 4.7 Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri në deklaratën e dorëzuar, por në procesverbalin e datës 12.09.2023 subjekti paraqiti shpjegime për burimin financiar të shumës 16.000 euro, transferuar në datë 29.10.2021, cili është nga të ardhurat dhe kursimet në vite si: pagat e subjektit, paga e bashkëshortes, interesat e bonove dhe obligacioneve të thesarit.
- 4.8 Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin dhe parashtrimet pranw ILDKPKI dhe

Trupës së Vlerësimit, rezulton se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.**
- ✓ **Konfirmohet pagesa e kryer në BKT.**

5. **Prenotim apartamenti**, nuk është aplikuar për regjistrim (fazë ndërtimi), kontratë nr. **** rep. dhe nr. 855 kol., datë 18.03.2022, nëpërmjet shoqërisë “A****” si palë shitëse dhe Lorenc Panganika si palë blerëse. Në kontratë përfshihet edhe garazh. Sipërfaqja totale e apartamentit 121.17 m² dhe sipërfaqe banimi neto 103.56 m². Apartamenti ndodhet në Lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, Elbasan.
- Vlera:** 50.887,20 euro

5.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin si vijon:

- Kontratë sipërmarrje (për prenotim apartamenti) nr. ****/855, datë 18.03.2022.
- Ekstrakti historik për subjektin “A****” shpk, të regjistruar në QKB.
- Nxjerrje llogari bankare në BKT, në emër të Lorenc Panganika.

HETIMI ADMINISTRATIV

5.2 Trupa e vlerësimit mori në shqyrtim deklarin e subjektit, dokumentacionin e përcjellë prej tij dhe institucioneve ligjzbatuese, si dhe korrespondencën e mbajtur me ILDKPKI-në dhe relatorin e çështjes, konkretisht:

5.3 Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. ****/855, datë 18.03.2022, subjekti ka prenotuar apartamentin kati i 8-të banimi, me sipërfaqe totale ndërtimi 121.17 m², në vlerën 50.887,20 euro. Likuidimi është dakordësuar nga të dy palët me tre këste.

5.4 **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. ** prot., datë 04.07.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Lorenc Panganika.

5.5 **BKT**, me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare, në monedhën euro të Lorenc Panganika, ku konstatohen veprimet si më poshtë shënuar:

- Në datën 29.10.2021, është transferuar vlera 16.000 euro, me përfitues “A****” shpk, me përshkrim “Kalim shume sipas kontratës prenotim apartamenti nr. ****, datë 13.10.2021”.
- Në datën 10.10.2022, është transferuar vlera 16.000 euro.
- Në datën 17.01.2023, është transferuar vlera 2.000 euro.

5.6 Nga kontrolli dhe verifikimi i deklaratës së pasurisë rezulton se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në rubrikën “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”.

5.7 Gjithashtu, në përshkrimin e pasurisë subjekti ka deklaruar vlerën prej 50.887,2 (pesëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë dy) Euro, ndërkohë që në vlerën me

shifra ra dhe fjalë ka deklaruar shumën 34.000 (tridhjetë e katërmijë) Euro.

5.8 Subjekti fillimisht ka deklaruar se në kontratë përfshihet edhe garazh.

5.9 Në lidhje me konstatimet e sipërcituara, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim se burimi financiar për pagesën e shumës prej 34.000 Euro transferuar nëpërmjet BKT është nga të ardhurat dhe kursimet në vite si; paga e tij, paga e bashkëshortes, interesat e bonove dhe obligacioneve të thesarit.

5.10 Në lidhje me dy kontratat e sipërmarrjes me këtë shoqëri shpjegoi se në fillim është lidhur kontrata nr. **** rep. dhe nr. **** kol., datë 13.10.2021, nëpërmjet “A****” si palë shitëse dhe Lorenc Panganika si palë blerëse (*bashkëlidhur ekstrakti historik për subjektin “A****” shpk, të regjistruar në QKB*).

5.11 Kjo kontratë është revokuar me kontratën nr. **** kol., datë 18.03.2022 dhe është lidhur kontrata nr. **** kol., datë 18.03.2022. Ky revokim është bërë, pasi është ndryshuar kati i apartamentit. Në kontratën e parë apartamenti ndodhej në katin e 7-të banim (sipas planimetrisë) ose i nëntë teknik, kuota 29.97, ndërsa në kontratën e dytë apartamenti ndodhet në katin e 8-të banim (sipas planimetrisë) ose i dhjetë teknik, kuota 33.20. Të dy këto apartamente kanë të njëjtën sipërfaqe totale, prej 121.17 m² (121.16 m² në kontratën e parë) dhe sipërfaqe neto 103.56 m².

5.12 Mos pasqyrimi i detyrimit financiar kundrejt kësaj shoqërie, është bërë “*pa dashje*” nga subjekti. Sqaroi se detyrimi financiar kundrejt kësaj shoqërie del qartë, pasi është cituar çmimi i blerjes në vlerën 50.887,2 Euro dhe është paguar shuma prej 34.000 euro. Detyrimi financiar kundrejt kësaj shoqërie, në datën e dorëzimit të deklaratës, është 16.887,2 Euro, çfarë ka del qartë edhe në deklaratat periodike vjetore të vitit 2021 dhe 2022 të dorëzuara pranë ILDKPKI-së.

5.13 Për sa i përket deklaramit se në kontratë përfshihet edhe një garazh, subjekti shprehet se ky është një gabim/lapsus i bërë nga ana e tij, ndërkohë që në deklaratat periodike vjetore nuk është bërë një deklaram i tillë.

5.14 Subjekti paraqiti dokumentacionin shtesë:

- a. Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti nr. ****, datë 13.10.2021, me palë sipërmarrëse shoqëria "A****" shpk, dhe porositës Lorenc Panganika të apartamentit në B8-27 me sip. neto 103.56 m², kati i 7 banim dhe i nëntë teknik, me sip. totale ndërtimi 121.16 m², në vlerën 50.887,2 euro.
- b. Revokim aktesh të tjera nr. ****, datë 18.03.2022, (zgjidhje kontrate) midis palëve shoqëria “A****” shpk dhe Lorenc Panganika, të cilët revokojnë/shfuqizojnë në mënyrë të menjëhershme kontratën e sipërmarrjes nr. ****, datë 31.10.2021.
- c. Kontratë sipërmarrje (për prenotim apartamenti) nr. ****, datë 18.03.2022.
- d. Deklaratë noteriale nr. ****, datë 12.06.2023, me deklarues shoqëria “A****” dhe Lorenc Panganika, të cilët deklarojnë se midis palëve është lidhur kontrata nr. ****, datë 18.03.2022, për blerje apartamenti me sip. neto 103.56 m², në katin e 8-të banim ose i 10-të teknik, në shumën 50.887 euro.

Shtetasi Lorenc Panganika ka shlyer shumën 34.000 euro dhe detyrimi i mbetur në datë 28.02.2023, është 16.887 euro.

5.15 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në shpjegimet e dhëna prej tij, rezulton se:

- ✓ Përputhet dokumentacioni me shpjegimet e subjektit në lidhje me kontratat e paraqitura, pagesat e kryera dhe detyrimin e mbetur në shumën 16.887 Euro, ndaj shoqërisë "A****" shpk.
- ✓ ASHK nuk konfirmon regjistrimin e apartamentit në emër të Lorenc Panganika.
- ✓ Konfirmohen pagesat e kryera në BKT.
- ✓ Brurimi i krijimit trajtuar tek të ardhurat.

6. **Obligacione Thesari** aplikuar nëpërmjet Raiffeisen Bank. Kategoria e llogarisë: Obligacione. Numri i llogarisë *****, data e investimit 07.07.2021 dhe datë maturimi 07.07.2031. Normë interesi 5 %.

Vlera nominale 10.800.000 lekë.

Pjesa takuese 100%.

6.1 Subjekti ka bashkëlidhur vërtetimin mbi shpalljen fitues nga ankandi i zhvilluar për obligacionet nga Ministria e Financave.

HETIMI ADMINISTRATIV

6.2 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari investimi në Obligacione Thesari, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 10.800.000 lekë. Konfirmohet data e investimit 07.07.2021 dhe data e maturimit 07.07.2031. Bashkëlidhur tabela përmbledhëse.

6.3 Vlera bruto e të ardhurave vjetore nga interesat llogaritet 270.000 lekë dhe tatimi në vlerën 40.500 lekë.

6.4 Në proces verbalin e datës 12.09.2023 sqaroi se burimi financiar për obligacionet në vlerën 10.800.000 lekë, janë nga të ardhurat dhe kursimet në vite si, paga e tij, paga e bashkëshortes, interesat e bonove dhe obligacioneve të thesarit dhe të depozitave bankare.

6.5 Trupa e vlerësimit kreu analizën financiare mbi mundësinë për kursim nga të ardhurat familjare të subjektit të depozituara ndër vite në BKT, Tirana Bank, Credins Bank dhe Raiffeisen Bank, si dhe interesat bankare e gjeneruara prej tyre, me qëllim investimin në Korrik të vitit 2021 në obligacione pranë Raiffeisen Bank, me vlerë 10.800.000 lekë dhe afat maturimi 10 vjet.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.
- ✓ Burimi financiar trajtuar tek të ardhurat e subjektit.

7. **Obligacione Thesari** aplikuar nëpërmjet Raiffeisen Bank. Kategoria e llogarisë: Obligacione. Numri i llogarisë *****, data e investimit 18.01.2023 dhe datë maturimi 18.1.2033.

Vlera nominale 4.633.000 lekë. Normë interesi 7.6 %.

Pjesa takuese 100%.

7.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion shoqërues:

- Kërkesë për blerje letra me vlerë obligacione, datë 06.01.2023, në Raiffeisen Bank.
- Vërtetim mbi shpalljen fitues nga Ankandi i Zhvilluar për Obligacionet nga Ministria e Financave nr. **.

HETIMI ADMINISTRATIV

7.2 Referuar vërtetimit mbi shpalljen fitues nga Ankandi i zhvilluar nga Ministria e Financave nr. **, vlera nominale e pranimi është 46.3% e vlerës së kërkuar nga subjekti, pra 4.633.000 lekë, të investuara më datë 18.01.2023. Frekuenca e kuponit është 6-mujore, me interes 7.6 %, në vlerën bruto 170.054 lekë dhe vlera e tatimit 26.408 lekë.

7.3 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari investimi në Obligacione, me datë investimit 18.01.2023 dhe datë maturimi 18.01.2033.

7.4 Në proces verbalin e datës 12.09.2023 pranë ILDKPKI, subjekti paraqiti shpjegime, ku sqaroi se si burim krijimi për obligacionet, në shumën 4.633.000 lekë kanë shërbyer gjithë të ardhurat dhe kursimet në vite si; paga e subjektit, paga e bashkëshortes, interesat e bonove dhe obligacioneve të thesarit dhe të depozitave.

7.5 Shuma 4.633.000 lekë është krijuar nga Obligacionet e Thesarit me të njëjtin nr. llogarie (numër ankandi **), datë emetimi 08.11.2017 dhe datë maturimi 08.11.2022, në shumën 9.771.000 lekë. Kjo shumë është kaluar në llogarinë rrjedhëse, së bashku me shumën 226.321 lekë, të interesit të fundit. Kësaj shumë i është bashkuar vlera prej 67.548 lekë, e cila ndodhej në llogari. Është aplikuar për Obligacione Thesari me afat 10-vjeçar, me datë 06.01.2023, në shumën 10.000.000 lekë dhe nga ankandi nr. ***, i zhvilluar në vitin 2023, vlera nominale e pranimi ishte 46.3% e shumës së investuar. Pjesa tjetër prej 5.367.000 lekë, u rikthye në llogarinë rrjedhëse me përshkrim në llogarinë e subjektit “*kthim fonde pro-ratash*”.

✓ Konstatohet se Obligacionet në Raiffeisen Bank, me vlerë 4.663.000 lekë, janë investuar në Janar 2023, me afat 10 vjeçar, me burim financiar nga kursimet familjare të depozituara ndër vite në BKT, Tirana Bank, Credins Bank dhe Raiffeisen Bank, si dhe interesat bankare e gjeneruara prej tyre.

✓ Konfirmohet deklarimi me përqijien e Raiffeisen Bank.

✓ Burimi financiar trajtuar tek të ardhurat e subjektit.

8. **Obligacione Thesari** aplikuar nëpërmjet Raiffeisen Bank. Kategoria e llogarisë: Obligacione. Numri i llogarisë *****, data e investimit 08.02.2023 dhe datë maturimi 18.02.2030.

Vlera nominale 1.840.500 lekë. Normë interesi 5%.

Pjesa takuese 100 %.

8.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim mbi shpalljen fitues nga Ankandi i Zhvilluar për Obligacionet nga Ministria e Financave nr. ***, me datë emetimi 08.02.2023.
- Kërkesë për blerje letra me vlerë, obligacione, datë 02.02.2023, në Raiffeisen Bank.

HETIMI ADMINISTRATIV

8.2 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari investimi në obligacione, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 1.840.500 lekë.

8.3 Në proces verbalin e datës 12.09.2023, subjekti paraqiti shpjegime, ku sqaroi se shuma e investuar prej 1.840.500 lekë është krijuar nga rikthimi i shumës 5.367.000 lekë, të ankandit *** (viti 2023), datë emetimi 18.01.2023 dhe datë maturimi 18.01.2033, plus shumën 544.418 lekë, e mbetur në balancë të llogarisë rrjedhëse dhe të kalimit të shumës 600.000 lekë nga llogaria në BKT e bashkëshortes. Më datë 02.02.2023 është aplikuar nëpërmjet Raiffeisen Bank, shuma 6.000.000 lekë, për obligacione thesari, me afat 7-vjeçar, në ankandin nr. 030 (viti 2023), ku është pranuar vlera 1.840.500 lekë, me interes 6 %.

8.4 **Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie**, subjekti deklaroi se është krijuar nga të gjithë të ardhurat dhe kursimet në vite si: paga e subjektit, paga e bashkëshortes, interesat e bonove dhe obligacioneve të thesarit dhe të depozitave bankare.

8.5 Konstatohet se:

- ✓ **Obligacionet në Raiffeisen Bank, me vlerë 1.840.500 lekë, janë investuar në Shkurt 2023, me afat 7 vjeçar, me burim financiar kursimet familjare të depozituara ndër vite në BKT, Tirana Bank, Credins Bank dhe Raiffeisen Bank, si dhe interesat bankare e gjeneruara prej tyre.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**
- ✓ **Burimi financiar trajtuar tek të ardhurat e subjektit.**

9. **Llogari rrjedhëse individuale** në Raiffeisen Bank. Kategoria e llogarisë: Obligacione. Numri i llogarisë *****, balanca në datë 28.02.2023.

Vlera: 4.724.338 lekë.

Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat, shpërblime, interesa të depozitave bonove dhe obligacioneve të thesarit. Pjesa takuese: 100 %.

HETIMI ADMINISTRATIV

9.1 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari page me balancë, në datë 01.03.2023, në vlerën 4.724.338 lekë, sikurse konstatohet edhe nga nxjerrja e llogarisë bankare bashkëlidhur.

9.2 Në proces verbalin e datës 12.09.2023, subjekti paraqiti shpjegime, ku sqaroi se vlera prej 4.724.338 lekë, në llogari të pagës, ka mbetur në balancë me datë 28.02.2023, pasi janë kryer investimet në obligacione të deklaruara më lart.

9.3 Konstatohet se:

- ✓ **Llogaria e pagës në Raiffeisen Bank, me vlerë 4.724.338 lekë, është deklaruar me burim financiar nga pagat familjare dhe interesat bankare.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijqjen e Raiffeisen Bank.**
- ✓ **Burimi financiar trajtuar tek të ardhurat e subjektit.**

PASURI TË TJETËRSUARA

30. Subjekti i vlerësimit nuk i ka deklaruar këto pasuri të luajtshme të tjetërsuara në momentin e dorëzimit të formularit të deklarimit të pasurisë. Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti ka detyrimin të deklarojë “*të gjitha pasuritë e akumuluar... në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit...*” në rubrikën “Deklarimi i Pasurive dhe Burimi i Krijimit”. Të gjitha pasuritë e luajtshme të cituara më poshtë do të trajtohen në këtë rubrikë, duke verifikuar dhe vlerësuar burimin e krijimit dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për blerjen e automjeteve, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre.

31. Bazuar në nxjerrjet e llogarive bankare në emër të Lorenc Panganika, dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR (dosjet/praktikat e mjeteve), si dhe dokumentacionin dhe sqarimet me shkrim të subjektit të vlerësimit pasi është pyetur mbi krijimin dhe tjetërsimin e këtyre pasurive të luajtshme, Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim si më poshtë vijon:

- 1) Mjetin me targë AY***** (AA*****), tip Fiat Punto, vit prodhimi 1998, blerë në datë 13.12.2011, në vlerën 500 euro, paguar dogana 22.095 lekë dhe shitur më datë 13.11.2015, në vlerën 100.000 lekë.
- 2) Mjetin me targë AA****, tip Opel Corsa (çregjistrim i përhershëm nga viti 2017), blerë më datë 14.05.2012, në vlerën 500 euro, paguar dogana 24.388 lekë dhe shitur më datë 12.10.2012, në vlerën 2.000 euro.
- 3) Autoveturën Mercedes Benz, të markës Daimlerchrysler, prodhim viti 1999, me targë R-DC770, (i pa regjistruar) blerë më datë 14.06.2012, në vlerën 2000 euro dhe paguar dogana

54.198 lekë dhe shitur më datë 08.04.2014, në vlerën 3.000 euro.

- 4) Mjetin me targë BL*** (AA***), tip Fiat Punto, blerë më datë 18.09.2013, në vlerën 300 euro, paguar doganë 24.339 lekë dhe shitur më datë 30.09.2016, në vlerën 3000 euro.
- 5) Mjetin Mercedes Benz me targa AA*** (AA ***J) (AA***Z), tip Daimlerchrysler, vit prodhimi 2000, blerë në datë 05.10.2015, në vlerë 1.300 euro dhe shitur më datë 29.04.2016 në vlerën 400.000 lekë.
- 6) Mjetin me targa AA***, tip Volkswagen Golf, vit prodhimi 2005, blerë më datë 26.10.2018, në vlerën 700 euro, paguar dogana 48.000 lekë dhe shitur më datë 11.02.2019, në vlerën 4.300 euro.
- 7) Mjetin me targa AA***, tip Volkswagen Tiguan, vit prodhimi 2008, blerë më datë 18.03.2019, në vlerën 2.200 euro, paguar dogana 62.909 lekë dhe shitur më datë 22.12.2019, në vlerën 6.500 euro.
- 8) Mjetin Daimlerchrysler (Mercedes Benz), me nr. shasie WDB*****, prodhim viti 2002, blerë më datë 04.07.2013 në vlerën 1.400 Euro, paguar doganen 54.196 lekë dhe shitur datë 23.08.2013, në vlerën 2.500 euro.

Subjekti paraqiti dokumentacion justifikues:

- a. Kontratë shitje nr. ***, datë 12.10.2012, të mjetit me targa AA****, tip Opel Korsa, në vlerën 2.000 euro.
- b. Dokument në gjuhë italiane: “*Shtetasi S. V., shet mjetin tip Opel Corsa, blerësit Lorenc Panganika, në vlerën 500 euro*”. Deklaratë doganore datë 14.05.2012, në vlerën 24.388 lekë.
- c. Kontratë shitje nr. ***, datë 08.04.2014, të mjetit të markës Daimlerchrysler.
- d. Kontratë shitje mjeti nr. ***, datë 05.04.2014, të mjetit të markës Daimlerchrysler, me nr. identifikimi WDB *****, me targa R-D***.
- e. Kontratë shitblerje nr. ***, datë 11.02.2019, të mjetit me targa AA** CD, tip Volkëagen Golf, vlerën 4.300 euro.
- f. Kontratë shitblerje nr. ****, datë 22.12.2019, të mjetit të markës Volksagen Tiguan, nr. identifikimi EV***, vit prodhimi 2008, në vlerën 6.500 euro.
- g. Kontratë shitje nr. ***, datë 10.05.2019, të mjetit tip Volkswagen Tiguan, në vlerën 2.200 euro. Deklaratë doganore datë 27.03.2019, vlera e zhdoganimit 72.529 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

32. **DPSHTRR**, me shkresën nr. 20/27 prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur të regjistruar në emër të tij mjetin me targë AA****. *Bashkëlidhur praktika.*
- 32.1 Referuar deklaratës së shitjes datë 13.12.2011, Z.L i ka shitur mjetin me targa **AY****** palës blerëse Lorenc Panganika, në vlerën 500 euro (69.480 lekë). Pagesa për

zhdoganimin e mjetit është kryer në shumën 22.095 lekë (sipas deklaratës doganore, datë 17.12.2011). Vlera totale e blerjes së mjetit është 91.575 lekë.

32.2 Sipas Kontratës së shit-blerjes nr. ****, datë 13.11.2015, rezulton se subjekti Lorenc Panganika i ka shitur mjetin me targa **AA******, tip Fiat Punto, palës blerëse L. S., në vlerën 100.000 lekë.

32.3 Trupa e Vlerësimit vëren se çmimi i shitjes së automjetit me targë **AA****** është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes së automjetit nga subjekti i vlerësimit, me një diferencë prej 8.425 lekë.

33. **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur të regjistruar në emër të tij mjetin me targë **AA******, i cili figuron në statusin çregjistrim i përhershëm). Bashkëlidhur praktika/dosja e mjetit.

33.1 Sipas dokumentit në gjuhën italiane, shtetasja S. V. i ka shitur mjetin tip Opel Corsa, blerësit Lorenc Panganika, në vlerën 500 euro (500 euro * 139.44 lekë/euro = 69.720 lekë). Bashkëlidhur deklarata doganore datë 14.05.2012, ku konfirmohet vlera e zhdoganimit prej 24.388 lekë.

33.2 Gjithashtu, nëpërmjet postës elektronike, DPSHTRR konfirmon se mjeti me targë **AA******, figuron në statusin çregjistrim i përhershëm nga viti 2017, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin justifikues.

33.3 Për mjetin me targa **AA**** Opel Corsa**, e vitit të prodhimit 2000, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim pranë ILDKPKI-së se e ka patur në pronësi dhe pasi e ka blerë në muajin Maj 2012, në vlerën 500 euro, ka paguar doganën në vlerën 24.338 lekë, taksat dhe siguracionin, ia ka shitur shtetasit Sh. S. nëpërmjet kontratës nr. *** kol., datë 12.10.2012, në vlerën 2.000 euro (2.000 euro * 139.72 lekë/euro = 279.440 lekë). Pas aktit të shitjes, ky shtetas nuk e ka ndryshuar pronësinë e mjetit dhe pas disa kohe (rreth 2 vjet), i është vjedhur mjeti. Pas kësaj është bërë çregjistrimi i mjetit.

33.4 Nga aktet e administruara, Trupa e Vlerësimit vëren se çmimi i shitjes së automjetit me targë **AA****** është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes së automjetit nga subjekti i vlerësimit, me një diferencë prej 185.332 lekë.

34. Në lidhje me autoveturën Mercedes Benz, Daimlerchrysler, prodhim viti 1999, Trupa e Vlerësimit, nga verifikimi i kryer vëren se në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës, datë 04.11.2023, pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: **“Autoveturë, Mercedes Benz e vitit të prodhimit 1999, me vlerë 2.500 euro”**; ndërkohë që në sqarimet me shkrim datë 12.09.2023, subjekti ka deklaruar se **“...ky mjet është blerë më datë 14.06.2012, në vlerën 2.000 euro...”**, si dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues pranë ILDKPKI-së kontratën nr. ***, datë 05.04.2014, për blerjen e këtij mjeti.

34.1 Mbi këtë mospërputhje në vlerë dhe datë blerje të autoveturës, subjekti paraqiti shpjegime me shkrim se, **“....automjeti Daimlerchrysler (Mercedes Benz), me nr. shasie ****, prodhim viti 1999, është blerë më datë 14.06.2012 në vlerën 2000 (dymije) Euro, paguar doganën 59.947 lekë dhe shitur me Kontrate nr. ** Rep. dhe ** Kol., datë 08.04.2014, në**

vlerën 3.000 euro. Pra, vlera e blerjes së mjetit dhe pagesa e doganës kapin vlerën rreth 2.500 Euro. Në shpjegimet me shkrim në proces verbalin e datës 12.09.2023, duhet të kem pasur parasysh vetëm vlerën e blerjes prej 2.000 euro.”

34.2 Më datë 08.04.2014, subjekti ka nënshkruar Kontratën e shitjes nr. ****, me palën blerëse A. S., të cilit i ka shitur mjetin në vlerën $3.000 \text{ euro} * 139.98 \text{ lekë/euro} = 419.940 \text{ lekë}$.

34.3 **BKT**, ka përcjellë nxjerrje llogari bankare të Lorenc Panganika, ku konstatohet se në datë 14.07.2014, është depozituar shuma 3.000 euro, me përshkrimin “nga shitje makine”.

34.4 Çmimi i shitjes së autoveturës Mercedes Benz, vit prodhimit 1999, është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes së mjetit me një diferencë prej 139.980 lekë.

35. **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur të regjistruar në emër të tij mjetin me targë **AA*****, tip Fiat Punto. *Bashkëlidhur dosja e mjetit.*

35.1 Referuar deklaratës së shitjes, datë 18.09.2013, pala shitëse z. E. I. i ka shitur palës blerëse z. Lorenc Panganika, mjetin me targë **BL*****, tip Fiat Punto, shasi nr. ZF*****, në vlerën $300 \text{ euro} * 140.74 \text{ lekë/euro} = 42.222 \text{ lekë}$. Subjekti ka paguar zhdoganimin e mjetit në shumën 24.339 lekë. Shuma totale e paguar nga subjekti është 66.561 lekë.

35.2 Sipas Kontratës shit-blerje automjeti nr. ***, datë 30.09.2016, subjekti i vlerësimit Lorenc Panganika i ka shitur palës blerëse znj. B. K. mjetin me targa **AA*****, tip Fiat Punto, në vlerën $3.000 \text{ euro} * 137.33 \text{ lekë/euro} = 411.990 \text{ lekë}$.

35.3 Çmimi i shitjes së automjetit me targë **AA***** është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes së automjetit nga subjekti i vlerësimit, me një diferencë prej 345.429 lekë.

36. **DPSHTRR**, me shkresën nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur të regjistruar në emër të tij mjetin me targë **AA*****. *Bashkëlidhur dosja e mjetit.*

36.1 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR mbi mjetin me targa **AA***** (**AA ***J**) (**AA***Z**), tip Daimler 210 dhe konkretisht:

36.2 Kontratën e shit-blerjes nr. ****, datë 05.10.2015, me palë shitëse I. Gj. dhe palë blerëse Lorenc Panganika, të mjetit me targa ***, tip Daimler Chrysler 210, në vlerën $1.300 \text{ euro} * 139.53 \text{ lekë/euro} = 181.839 \text{ lekë}$.

36.3 Kontratën e shit-blerje nr. ****, datë 29.04.2016, me palë shitëse Lorenc Panganika dhe palë blerëse J. K., të mjetit me targa **AA**J**, tip Daimler 210, shasia nr. **ED****844**, në vlerën 400.000 lekë.

36.4 Çmimi i shitjes së automjetit me targa **AA****** (**AA ***J**) është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes me një diferencë prej 218.611 lekë.

37. **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur të regjistruar në emër të tij mjetin me targë **AA***K**. *Bashkëlidhur dosja e mjetit.*

37.1 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR mbi mjetin me targa AA***K, tip Volkswagen Golf, si dhe sqarimet me shkrim të subjektit të vlerësimit, nga ku rezulton se:

37.2 Sipas Kontratës së shitjes datë 26.10.2018, pala shitëse K. Ch. i ka shitur palës blerëse Lorenc Panganika, mjetin tip Volkswagen Golf, në vlerën 700 euro. *Bashkëlidhur:*

- Deklaratë doganore datë 04.11.2018, ka paguar shumën 47.599 lekë për zhdoganim.
- Pagesë fature datë 04.11.2018, në Credins Bank, nga Lorenc Panganika, në vlerën 48.000 lekë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganës.

37.3 Subjekti, në cilësinë e palës shitëse, i ka shitur palës blerëse D. J., mjetin me targa AA***K, tip Volkswagen Golf, në vlerën 4.300 euro, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shit-blerjes nr. ***, datë 11.02.2019.

37.4 **BKT**, ka përcjellë nxjerrje llogari bankare të z. Lorenc Panganika, ku konstatohet se:

- Më datë 27.02.2019, është kredituar vlera 4.000 euro, të ardhura nga shitja e mjetit.

15.5 Çmimi i shitjes së automjetit me targa AA***K, tip Volkswagen Golf, është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes me një diferencë prej 3.600 euro * 124.16 lekë/euro = 446.976 lekë.

38. **Autoveturë tip Volkswagen Tiguan**, e pa regjistruar, me numër identifikimi ËV****4, viti i prodhimit 2008. Blerë në vlerën 2.200 euro, paguar dogana 62.909 lekë.

38.1 **DPSHTRR**, nëpërmjet postës elektronike konfirmon se mjeti me targa AA***M, tip Volkswagen, është i regjistruar për herë të parë dhe aktualisht në pronësi të shtetasit K.B. D., në sistemit elektronik të mjeteve të DPSHTRR.

38.2 Sipas kontratës së shitjes nr. **, datë 10.05.2019, rezulton se subjekti Lorenc Panganika, ka blerë mjetin tip Volkswagen Tiguan në vlerën 2.200 euro * 123.37 lekë/euro = 271.414 lekë. Bashkëlidhur deklarata doganore datë 27.03.2019, me vlerë zhdoganimi 72.529 lekë.

- Shuma totale e paguar për mjetin është 343.943 lekë.

38.3 Referuar kontratës së shit-blerjes nr. ****, datë 22.12.2019, Lorenc Panganika i ka shitur palës blerëse K. B. D., mjetin e markës Volkswagen Tiguan, vit prodhimi 2008, në vlerën 6.500 euro. (6.500 euro * 121.51 lekë/euro = 789.815 lekë).

38.4 **BKT**, ka përcjellë nxjerrje llogari bankare të Lorenc Panganika, ku konstatohet veprimi:

- Më datë 24.12.2019, depozitim cash, në shumën 6.000 euro, nga shitja e mjetit.

38.5 Çmimi i shitjes së automjetit me targa AA150ZM, tip Volkswagen, është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes me një diferencë prej 445.872 lekë.

39. Daimlerchrysler (Mercedes Benz), me nr. shasie WDB***** prodhim viti 2002, blerë më datë 04.07.2013 në vlerën 1.400 (një mijë e katërqind) euro, paguar doganën 54.196 (pesëdhjetë e katërmijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë dhe shitur me Kontratë nr. *** Rep. dhe *** Kol., datë 23.08.2013, në vlerën 2500 (dymijë e pesëqind) Euro.

39.1 Ky mjet është deklaruar nga subjekti i vlerësimit gjatë korrespondencës me Trupën e Vlerësimit, për të cilin ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues.

39.2 Subjekti ka dhënë sqarime se, "...në përgjigjen e datës 12.09.2023 dërguar ILDKPKI-së, është deklaruar në përgjigje të pyetjes 13 (e dyta në renditje pas autoveturës Opel Corsa). Në kohën e blerjes dhe shitjes së automjetit të mësipërm nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe në deklaratën periodike nuk është deklaruar (e cituar edhe në përgjigje)..."

REZULTATE MBI PASURITË E LUAJTSHME TË TJETËRSUARA

40. Në lidhje me të gjitha pasuritë e luajtshme të tjetërsuara të trajtuara më sipër, në proces verbalin e datës 12.09.2023, subjekti paraqiti shpjegime në lidhje me konfirmimet e DPSHTRR, si dhe kreditimet e kryera nga të ardhurat nga shitja e mjeteve në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT).

- i. Subjekti sqaroi se, nuk e ka kuptuar se duhej të deklaronte pronësinë dhe tjetërsimin e mjeteve të mësipërme në Deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar.
- ii. Sqaroi se, burimi financiar për blerjen e mjeteve janë të ardhurat nga kursimet familjare dhe interesat bankare, duke shtuar se, shitjet e mjeteve kanë shërbyer për blerjen e mjetit në vijim përveç rasteve kur ka depozituar vlerën e shitjes së mjetit në bankar sipas shpjegimeve të dhëna.
- iii. Mjetet janë blerë nga subjekti, në vite të ndryshme, për përdorim vetjak dhe jo për qëllim fitimi. Mjetet janë blerë më lirë dhe janë shitur më shtrenjtë për faktin sepse ka kryer riparime në vlera jo shumë të larta. Këto shpenzime janë bërë në periudha të ndryshme dhe jo të menjëhershme. Për riparimin e tyre nuk disponon dhe nuk ka ruajtur dokumentacion.
- iv. Paraqiti dokumentacion në lidhje me pagesën e tatim fitimit për shumën 15% të paguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si vijon:
 - Njoftim debitimi datë 26.06.2023, nga Raiffeisen Bank, nga shtetasi Lorenc Panganika, në shumën 250.665 lekë, me përshkrimin "tatim mbi të ardhurat personale 2018 - 2019 + gjoba".
 - Njoftim debitimi datë 26.06.2023, nga Raiffeisen Bank, nga shtetasi Lorenc Panganika, në shumën 18.829 lekë, me përshkrimin "tatim mbi të ardhurat personale + gjoba".
 - Deklaratat Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) në emër të Lorenc Panganika, për periudhat tatimore 2016, 2018 – 2022.

41. Gjatë kontrollit dhe verifikimeve të kryera, Trupa e Vlerësimit konstatoi disa paqartësi, kontradiktoritet në përgjigjet e subjektit të vlerësimit, si dhe rezultoi se tatim-fitimi nuk ishte kryer nga subjekti në momentin/periudhën tatimore që janë kryer transaksionet.
42. Për këtë qëllim, më datë 11.03.2024 dhe 12.03.2024, subjekti paraqiti pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policor, shpjegime dhe dokumentacion shtesë në lidhje me deklarimin, paqartësitë dhe pagesat e tatimit për të ardhurat e krijuara nga shitja e automjeteve me çmim më të lartë sesa çmimi i blerjes.
43. **Në përgjigjen e tij përfundimtare subjekti ka dhënë shjegime se** “...nga ana tij është paraqitur dokumentacioni në Drejtorinë e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve për sa i përket të ardhurave individuale dhe tatimit për fitimin nga shitja e pasurive të luajtshme (autoveturave)”.
44. Nga dokumentacioni (Deklaratat Individuale Vjetore të të Ardhurave) i përcjellë nga subjekti pranë Trupës së Vlerësimit më datë 13.03.2024, rezulton si më poshtë vijon:
- 44.1 Më datë 11.03.2024 janë kryer veprimet në Drejtorinë e Tatimeve për pagimin e tatimit mbi detyrimet për vitin 2012 në shumën 15.864 lekë për mjetin Opel Corsa me targë AA ****J.
- 44.2 Më datë 11.03.2024 janë kryer veprimet në Drejtorinë e Tatimeve për pagimin e tatimit mbi detyrimet për vitin 2013 në shumën 11.653 lekë, për mjetin Daimlerchrysler (Mercedes Benz), me nr. shasie WDB ***.
- 44.3 Më datë 11.03.2024 janë kryer veprimet në Drejtorinë e Tatimeve për pagimin e tatimit mbi detyrimet për vitin 2014 në shumën 1.000 leke, për mjetin Fiat Punto, me targë AA 092 CD.
- 44.4 Më datë 11.03.2024 janë kryer veprimet në Drejtorinë e Tatimeve për pagimin e tatimit mbi detyrimet për vitin 2015 në shumën 5.644 leke, për mjetin Daimlerchrysler (Mercedes Benz), me nr. shasie WDB *****.
- 44.5 Më datë 19.06.2023 janë kryer veprimet në Drejtorinë e Tatimeve për pagimin e tatimit mbi detyrimet për vitin 2016 në shumën 46. 751 lekë, për 2 mjetet Fiat Punto me targë AA*** HG dhe Daimlerchrysler (Mercedes Benz), me targë AA *****.
- 44.6 Më datë 23.06.2023 janë kryer veprimet në Drejtorinë e Tatimeve për pagimin e tatimit mbi detyrimet për vitin 2019 në shumën 85. 979 leke për 2 mjetet Volkswagen Golf, me targë AA****K dhe Volkswagen Tiguan, me nr. shasie EVG****.
- 44.7 Ndërsa pagesa nga Raiffeisen Bank është kryer pas 2-3 ditëve, pas veprimeve në sistem të tatimeve.

45. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

45.1 **Të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, veshje civile** etj. - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga data 01.08.1993 - 28.02.2023, në vlerën 22.909.500 lekë. Mund të ketë mospërputhje nga rakordimet ndër vite.

45.2 **Të ardhura nga Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë.** Shuma neto 3.200.000 lekë. Shënim: Të ardhura nga investimi në obligacione vjetore, në total 462.443 lekë. (për vitin 2012, 2013 dhe 2014).

45.3 **Të ardhura nga depozita bankare 5 vjeçare, në BKT** (kontratë depozitë). Shuma e depozitës 5.000.051 lekë. Periudha: Data e emetimit 22.05.2015 dhe datë maturimi 22.5.2020. Norma e interesit 4.5 %. Shuma vjetore e interesit 1.125.388 dhe neto 956.580 lekë. Vlera 478.290 lekë.

45.4 **Të ardhura nga interesa bankare investimi në obligacione në Raiffeisen Bank sh.a.** Shuma e investuar 9.771.000 lekë. Datë emetimi 08.11.2017 dhe datë maturimi 08.11.2022. Norma vjetore e interesit 5.45 %. Shuma 6-mujore e interesit 266.259 lekë. Vlera 2.698.377 lekë.

45.5 **Të ardhura nga interesa bankare investimi në obligacione në Raiffeisen Bank sh.a.** Shuma e investuar 10.800.000 lekë. Datë emetimi 07.07.2021 dhe datë maturimi 07.07.2031. Norma vjetore e interesit 5 %. Shuma 6-mujore e interesit 270.000 lekë. Vlera 810.000 lekë. (përfituar deri në dorëzimin e deklaratës me tre këste)

41.6 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

- a. Vërtetim page nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, Drejtoria Vendore e Policisë Berat.
- b. Tabela përmbledhëse e të ardhurave të llogaritura nga subjekti.
- c. Kontratë depozitë bankare 5-vjeçare në BKT, datë 22.05.2015, në emër të Lorenc Panganika.
- d. Kartela e klientit nga Banka e Shqipërisë, në emër të Lorenc Panganika.

HETIMI ADMINISTRATIV

46. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dhe analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti dhe institucionet ligjzbatuese, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

47. Lorenc Panganika ka përfituar të ardhura nga paga, për periudhën 01.01.1994 - 15.10.2001, në vlerën 1.130.788 lekë dhe për periudhën 01.04.2003 - 30.04.2004, vlera 588.477 lekë, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 22.09.2022 nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan.

48. Referuar vërtetimit të pagës nr. *** prot., datë 16.04.2018, për periudhën 01.01.1994 - 30.04.2004, subjekti ka përfituar:

- Të ardhura nga paga, në vlerën 2.568.312 lekë.
- Të ardhura nga taksa e solidariteti, në vlerën 179.712 lekë.

- Të ardhurat nga shpërblimet, në vlerën 43.200 lekë.
49. Sipas vërtetimit të pagës nr. ** prot., datë 12.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, konfirmohet se Lorenc Panganika ka qenë punonjës policie në Komisariatit e Policisë Elbasan, ku për periudhën 01.08.1993 - 31.12.1993, nuk disponohen bordero apo listë pagesa.
 50. Lorenc Panganika ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën 16.10.2001 - 30.06.2002 dhe 01.05.2004 - 31.08.2004, në vlerën 482.266 lekë, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 12.04.2018, nga DPPSH.
 51. Konfirmohen të ardhurat nga paga të Lorenc Panganika për periudhën 01.07.2002 - 31.03.2003, në vlerën 261.958 lekë, referuar vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë.
 52. Drejtoria Vendore e Policisë Berat, konfirmon të ardhurat nga paga të Lorenc Panganika, për periudhën 11.09.2004 - 20.10.2005, në vlerën 805.245 lekë.
 53. Për periudhën 01.01.2006 – 01.03.2023, janë kredituar të ardhurat nga pagat, shpërblime, honorarë, veshmbathje, në vlerën rreth 19.560.817 lekë.
 54. **Tirana Bank** me shkresën nr.** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur llogari bankare në monedhën lekë, e cila është mbyllur në vitin 2014. Bashkëlidhur: - Nxjerrje llogari bankare të Lorenc Panganika, ku i është kredituar paga për periudhën 02.03.2011 - Qershor 2011, në vlerën 310.400 lekë.
 55. **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.5.2023, konfirmon se Lorenc Panganika përfiton të ardhura nga punësimi pranë subjekteve “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Policisë Berat, Drejtoria e Përqasjes Juridike Ndërkombëtare, Komisariati i Policisë Shkodër, Akademia e Sigurisë, Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, Drejtoria Vendore e Policisë Fier”, për periudhën Janar 2012 - Mars 2023.
 56. Në lidhje me disa mospërputhje në vlerë të shumës së të ardhurave të deklaruara nga pagat, interesat bankare, etj., në proces verbalin e datës 12.09.2023, subjekti paraqiti shpjegime se mund të ketë mospërputhje të vlerave të deklaruara nga interesat dhe shkak mund të jetë mos përfshirja e tatimit në burim.
 57. Përveç sa sipër, subjekti shtoi se nëna e tij P. Th., faktikisht ka një sipërfaqe toke arë (prej 4 dynym), por për shkak të sëmundjes dhe zotësisë për të vepruar, kjo tokë është në emër të të ndjerit dajës së subjektit P. Th., i cili ka pasur kujdestarinë e saj. Kjo sipërfaqe toke është përfituar sipas Ligjit nr. 7501 dhe ndodhet në fshatin Drithas, bashkia Maliq, nga e cila janë marrë produkte bujqësore.
 58. Subjekti paraqiti:
 - Vërtetim për bazën e vlerësueshme të Lorenc Panganika, i punësuar pranë DVP Elbasan

për periudhën 20.10.2005 - 31.12.2005, në vlerën rreth 138.058 lekë.

- Nxjerrje llogarie bankare, pranë RFZ Bank, në emër të Lorenc Panganika, për periudhën Prill 2005 - Maj 2023.
- Nxjerrje llogarie bankare pranë Tirana Bank, në emër të Lorenc Panganika, për periudhën Mars 2011 - Nëntor 2014.
- Deklaratë noteriale nr. ***/*** datë 12.09.2023, me deklarues Dh. Th., i cili deklaron se babai i tij P. Th. ka pasur tokë me sipërfaqe 22.000 m², e përfituar nga ligji nr. 7501, ku 4.000 m² i ka pasur në përdorim motra e babait P. Th, e cila ka qenë në kujdestarinë e babait të tij.
- AMTP nr. ***, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 15.09.2012.

59. Në proces verbalin e datës 19.10.2023, subjekti deklaron se gjatë kryerjes së detyrës në qarqe të ndryshme, pjesëtarët e familjes (E., K. dhe N. Panganika) në të shumtën e kohës kanë qëndruar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes, P. dhe V. M. Kjo është bërë, për ndihmë për kujdesin e fëmijëve, dërgimin dhe marrjen e tyre nga shkolla, si dhe mos qëndrimin vetëm, pasi ishin dhe janë në moshë të vogël. Si rrjedhojë kjo ka çuar në uljen e shpenzimeve të jetesës. Subjekti ka dhënë shpjegime se ka qëndruar në familje kryesisht në fundjavë.

60. Pothuajse në të gjithë periudhën e punësimit të tij jashtë vendbanimit, akomodimi i subjektit ka qenë pranë vendit të punës, konkretisht në:

- Drejtorinë Vendore të Policisë Fier (17.12.2022 - 01.03.2023);
- DVP Tiranë (19.10.2021 - 16.12.2022);
- DVP Korçë (19.02.2018 - 11.06.2020);
- DVP Gjirokastrë (28.04.2017 - 18.02.2018);
- DVP Shkodër (11.02.2015 - 24.07.2016);
- DVP Berat (11.09.2004 - 30.10.2005 dhe 9.10.2013 - 12.10.2014);
- Akademinë e Sigurisë Tiranë (25.07.2016 - 27.04.2017);
- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; sektorë të ndryshëm (31.10.2005 - 31.10.2007, 14.01.2011 - 08.10.2013, 13.10.2014 - 10.02.2015 dhe 12.06.2020 - 18.10.2021);
- Akademia e Policisë (01.11.2007 - 13.01.2011); etj.
- Gjatë periudhës së punës pranë DVP Korçë (19.02.2018 - 11.06.2020), ka qëndruar pranë të afërmeve të tij.

61. Në inventarin e datës 06.11.2023, subjekti paraqiti:

61.1 Deklaratë datë 20.10.2023, nga shtetasja V. M, e cila deklaron se për t'i ardhur në ndihmë vajzës së saj Entela Panganika, së bashku me fëmijët, për shkak të natyrës së punës së bashkëshortit, ku pjesën më të madhe të viteve të punës pas martesës e ka pasur dhe e ka larg vendqëndrimin, në qarqe të ndryshme, kanë qëndruar në të shumtën e kohës në shtëpinë e deklarueses. Kjo është arsyeja që fëmijët kanë studiuar pranë shkollës "Luigj Gurakuqi", e cila ndodhet pranë banesës së deklarueses. Shpenzimet janë përballuar nga pagat, gjatë periudhës kur kanë qenë të punësuar, pensionet, ndihmën e vazhdueshme që ju ka dhënë vajza tjetër, M. G (Mitrollari) së bashku me bashkëshortin e saj H. G, të cilët

punojnë dhe jetojnë në Kanada.

61.2 Vërtetim nga ISSH nr. ** prot., 06.11.2023, që konfirmon se P. M. ka përfituar nga pensioni i pleqërisë për periudhën 01.10.2011 - 26.03.2021, në vlerën 2.741.340 lekë dhe të ardhura nga punësimi për periudhën 01.01.1994 - 30.09.2011, në vlerën rreth 3.417.000 lekë.

61.3 Vërtetim nga ISSH nr. *** prot., 06.11.2023, që konfirmon se V. M ka përfituar nga pensioni i pleqërisë për periudhën 01.06.2008 - 01.04.2023, në vlerën rreth 5.107.000 lekë dhe të ardhura nga punësimi për periudhën 01.01.1994 - Maj 2008 , në vlerën rreth 3.414.000 lekë.

61.4 CV - në emër të Lorenc Paganika, për periudhën e punës nga viti 1993 - 06.07.2023.

61.5 Dokumentacion në lidhje me të ardhurat, taksat në emër të M. dhe H. G., për periudhën 2005 - 2022, në shtetin e Kanadasë. Të ardhurat bruto në total rezultojnë, për periudhën 2006 - 2022 janë në shumën rreth 650.000 dollarë kanadeze. (Dokumentacion në gjuhën angleze).

62. **BKT** me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Lorenc Paganika ka depozitë në monedhën lekë, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 0 lekë. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare, ku rezultojnë të jenë kredituar interesa në vlerën 956.580 lekë.

63. Referuar tabelës së pagesave të interesave për depozitën bankare 5-vjeçare në Bankën Kombëtare Tregtare, (datë 22.05.2015) në shumën 5.000.051 lekë, me normë interesi 4.5%, Lorenc Paganika ka përfituar të ardhura bruto nga interesat bankare në vlerën 1.125.383 lekë dhe të ardhura neto 956.580 lekë, të pasqyruara si më poshtë:

TË ARDHURA (në lekë)	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Total
Të ardhura nga interesat e depozitës BKT	96,936	190,785	191,195	191,252	191,252	95,160	956,580

64. **Banka e Shqipërisë**, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Paganika rezulton të ketë hapur llogari për blerjen e bonove të thesarit të shtetit dhe ka përcjellë informacion mbi gjendjen e klientit Lorenc Paganika.

65. Kartela e klientit në emër të Lorenc Paganika nga Banka e Shqipërisë, konfirmon se subjekti ka investuar në instrumentin financiar Bono Thesari, në vlerën 3.200.000 lekë, ku për periudhën 30.04.2012 - 30.04.2015, ka përfituar interesa bruto në vlerën 505.346 lekë dhe tatimi i mbajtur në vlerën rreth 55.851 lekë. Në tabelën më poshtë janë llogaritur nga Trupa e Vlerësimit të ardhurat neto sipas viteve nga interesat e përfituar nga Bonot e Thesarit.

TË ARDHURA NETO (në lekë)	2012	2013	2014	Total
Të ardhura nga interesat 2012 Bono Thesari Ank 1532	217,540			217,540

Të ardhura nga interesat 2013 Ank 1582		157,621		157,621
Të ardhura nga interesat 2014 Ank 1635			87,282	87,282
TOTAL	217,540	157,621	87,282	462,443

66. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari investimi në obligacione. Bashkëlidhur: Tabela përmbledhëse, ku konfirmohet se Lorenc Panganika ka investuar në shumën 9.771.000 lekë, me datë investimi 08.11.2017 dhe datë maturimi 08.11.2022.

66.1 Gjithashtu, kjo vlerë konfirmohet edhe nga dokumenti nga BOA, në emër të Lorenc Panganika, konkretisht vërtetimi mbi shpalljen fitues nga Ankandi i Zhvilluar për Obligacionet nga Ministria e Financave nr. **, me datë emetimi 08.11.2017 deri në datë 08.11.2022, të shumës 9.771.000 lekë. Frekuenca e kuponit është 6-mujore, me interes 5.4 %, në vlerën 266.259 lekë dhe tatimi 39.938 lekë.

66.2 Nga nxjerrja e llogarisë së pagës pranë Raiffeisen Bank në emër të Lorenc Panganika, konfirmohen kreditimet:

- Për periudhën 08.11.2017 - 08.11.2022, kredituar vlera bruto 2.662.590 lekë, me përshkrimin “Kupon 5Y Ank 32”.
- Për periudhën 07.01.2022 - 19.01.2023, kredituar vlera bruto 810.000 lekë, me përshkrimin “Kupon 10Y Ank 0023”.
- Për periudhën 08.05.2018 - 09.01.2023, debituar vlera 520.890 lekë, me përshkrimin “Tatim kuponit”.

66.3 Nga nxjerrja e llogarisë bankare, Trupa e Vlerësimit llogariti të ardhurat neto të përfituara nga interesat e gjeneruara nga Obligacionet “Kupon 10Y Ank 0023” dhe “Kupon 5Y Ank 32” vit pas viti, deri më datë 01.03.2023, ku rezulton si vijon:

TË ARDHURA (në lekë)	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total
Të ardhura nga Obligacione Kupon 5Y	452,642	452,642	452,642	452,642	452,642			2,263,210
Të ardhura nga Obligacione Kupon 10Y					229,500	229,500	229,500	688,500
Total								2,951,710

67. Në përfundim të hetimit, Trupa e Vlerësimit konstaton:

- ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet. etj., për periudhën Janar 1994 - Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 23.393.154 lekë.
- ✓ Interesat bankare për periudhën 2017 - 19.01.2023, janë llogaritur në vlerën neto rreth 2.951.710 lekë.
- ✓ Të ardhurat nga interesat bankare, obligacione, bono thesari, për periudhën 2015 - 01.03.2023, janë në vlerën rreth 4.370.725 lekë.

- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me të ardhurat e prindërve dhe të motrës së bashkëshortes në Kanada, përdorur për shpenzime jetese të tyre, përfshirë pjesërisht edhe bashkëshorten dhe fëmijët e tij gjatë ushtrimit të funksionit të subjektit larg vendbanimit.

68. **DETYRIME FINANCIARE**

Kredi bankare në Raiffeisen Bank, për banesë. Nga data 25.10.2011 deri më datë 31.10.2031.

Shuma totale 2.500.000 lekë, kohëzgjatje 240 muaj. Shuma e detyrimit të mbetur 1.087.168 lekë.

Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

69. Kontratë kredi bankare dhe hipotekore nr. ****, datë 25.10.2011, midis palës kredi dhënëse Raiffeisen Bank dhe palës kredi marrëse Lorenc Panganika, Entela Panganika, hipotekues K.P dhe K.P., të vlerës 2.500.00 lekë, me qëllim blerje shtëpie, me afat 240 muaj, me interes bankar në vlerën 4%. Shuma do të kalojë në llogari të palës sipërmarrëse, shoqërisë “Alb-Gre” shpk., sipas akt-marrëveshjes nr. ***, datë 16.09.2011. Sigurim i shumës së kredisë është vendosur mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 60 m², me nr. ***, ZK 8522, vol. 11, fq. 110, në adresën lagjja “Brigada e 17 Sulmuese”, Elbasan. Pasuria figuron e regjistruar në emër të hipotekuesve.
70. Nxjerrje llogari bankare datë 07.03.2023, në Raiffeisen Bank, në emër të Lorenc Panganika, ku detyrimi financiar, në datën 02.02.2023, është në vlerën 1.087.168 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

71. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. 20/2 prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka kredi bankare, me detyrim financiar në datë 01.03.2023, në vlerën 1.087.168 lekë.
- 71.1 **Nga pasqyra e lëvizjeve bankare mbi pagesat e kryera të kredisë dhe atyre të mbetura për t’u paguar, Trupa e Vlerësimit llogariti detyrimin e principalit të mbetur (1.078.406 lekë) dhe interesave (209.764 lekë) deri më datë 01.03.2023.**
72. Sipas nxjerrjes së llogarisë bankare bashkëlidhur, më datë 31.10.2011 është disbursuar kredia në vlerën 2.500.000 lekë dhe në datë 02.12.2011 është debituar vlera 2.470.000 lekë, me përfitues “A** G**” shpk., me përshkrimin “Likuidim për blerje apartamenti”.
73. **Tirana Bank**, me shkresën nr.** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur llogari bankare në monedhën lekë, e cila është mbyllur në vitin 2014.
74. Subjekti ka dhënë shpjegime se zgjidhja e kontratës është bërë me mirëkuptim, për arsye se shitësi do të ndërtonte një pallat tjetër në qendër të qytetit, i cili do të ishte më cilësor. Sqaroi se kredia e marrë ka qenë vetëm për strehim dhe shuma është përdorur nga subjekti për të parapaguar për blerje apartamenti, në tre raste, por që kontratat dhe marrëveshja

midis palëve janë revokuar. (A**-G**, E***, dhe A****).

75. Subjekti nuk i ka deklaruar këto kontrata për prenotim apartamenti dhe revokimet e tyre në formularin e deklaratës së pasurisë, duke dhënë sqarime ka deklaruar vetëm kredinë bankare dhe nuk e ka ditur që duhet të pasqyronte kontratat dhe revokimet e tyre për blerje apartamentesh nga shoqëritë A**-G**, Ermir, dhe A****, në deklaratën e dorëzuar në datën 01.03.2023. ***(Trajtuar më poshtë kontratat E**** dhe A****).***
76. Trupa e vlerësimit mori në shqyrtim deklarinë në formularin e pasurisë, përgjigjet e dhëna me shkrim ILDKPKI-së datë 12.09.2023 si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, konkretisht:
- a) Akt-marrëveshjen, datë 16.09.2011, midis palës shitëse J. G. (investitor dhe sipërmarrës) dhe palës blerëse z. Lorenc Panganika, për prenotimin e një apartamenti në katin e dhjetë banimi me sipërfaqe 99 m², ku citohet se “çmimi i apartamenti është 4.000.000 lekë, nga të cilat janë likuiduar 1.500.000 lekë dhe diferenca do t'i likuidohet sipërmarrësit në momentin e lëvrimit të kredisë...”
 - b) Kontratën e kredisë bankare dhe hipotekore nr. ***, datë 25.10.2011, për vlerën 2.500.00 lekë, me qëllim blerje shtëpie, me afat 240 muaj, me interes bankar në vlerën 4%, ku citohet se “...shuma do të kalojë në llogari të palës sipërmarrëse, shoqërisë "A**-G**" shpk, sipas akt marrëveshjes nr. ****, datë 16.09.2011.”
 - c) Deklaratën nr. ***, datë 15.12.2011, ku subjekti ka deklaruar se anulon me të gjitha efektet juridike dhe financiare akt marrëveshjen e legalizuar më datë 17.09.2011. *(Bashkëlidhur vërtetim nr. ***, datë 17.09.2011).*
77. Në lidhje me periudhën dhe mënyrën e likuidimit të shumës 1.500.000 lekë kundrejt palës shitëse J. G. , si dhe nëse subjekti disponon një dokument që vërteton kryerjen e pagesës cash 1.500.000 lekë (si për shembull mandat arkëtimi të shoqërisë A**-G** shpk), subjekti dha sqarime me shkrim më datë 12.02.2024, se *shuma prej 1.500.000 është likuiduar kesh, nga ana e tij ditën e lidhjes së kontratës (para nënshkrimit, mesa i kujtohet). Për këtë nuk disponon dokument dhe nuk është përpiluar ndonjë dokument që vërteton kryerjen e pagesës kesh, pasi kjo është përcaktuar/përshkruar në nenin 3, të Akt - Marrëveshjes dhe nënshkruar nga palët. Subjekti ka vlerësuar se nuk kishte ndonjë rëndësi për ndonjë dokument tjetër (mandat arkëtimi) pasi vërtetohet në Akt-Marrëveshje.*
78. Gjithashtu, në përgjigjet e datës 12.02.2024, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj vlerë cash prej 1.500.000 lekë, me të cilat ka likuiduar z. J. G., subjekti sqaroi se, *“burimi i krijimit të shumës 1.500.000 leke, është nga të ardhurat familjare (të subjektit dhe bashkëshortes) në vite. Tërheqja e tyre duhet të jetë bërë nga llogaria e tij në Bankën Tirana.”*
79. Referuar nxjerrjes së llogarisë në Tirana Bank, datë 27.12.2019, në emër të subjektit, ku J.

G., më datë 06.12.2011, ka derdhur në llogarinë e z. Panganika shumën 2.470.000 lekë më përshkrimin “Derdhur për zgjidhje akt-marrëveshje nga puna” rezulton se kjo vlerë është tërhequr si vijon:

- 1.170.000 lekë, datë 06.12.2011;
- 700.000 lekë, datë 21.12.2011;
- 603.000 lekë, datë 07.03.2012.

80. I pyetur mbi destinacionin e këtyre vlerave të tërhequra prej tij, subjekti dha shpjegime nëpërmjet e-mailit të datës 12.02.2024, se vlerat e tërhequra nga ana e tij në Tirana Bank, janë derdhur në BKT (në muajin Shkurt dhe në vijim, si dhe shprehet se nuk është i saktë në çdo transaksion për shkak të kohës së gjatë). Ka bashkëlidhur ekstraktin nga BKT.

81. Trupa e Vlerësimit vëren se, rezulton një mospërputhje ndërmjet datës së nënshkrimit të deklaratës së noterizuar (15.12.2011) për revokimin e akt-marrëveshjes dhe datës së depozitimit (06.12.2011) të shumës 2.470.000 lekë në llogarinë e subjektit, nga z. J. G. . Asnjë nga palët nuk është shprehur në deklaratën e revokimit se zgjidhja e marrëveshjes është dakordësuar para kësaj date, sikurse nuk është shprehur as mbi periudhën dhe mënyrën e likuidimit të të gjithë vlerës.

82. Në përgjigjet e tij me shkrim më datë 12.02.2024, subjekti është shprehur se, “...në deklaratën për zgjidhjen e marrëveshjes citohet se; “Deklaruesi Lorenc Panganika, deklaroi se anulon me të gjitha efektet juridike dhe financiare akt marrëveshjen e legalizuar në noterinë Elbasan, noter I. P., datë 17.09.2011 dhe deklaroi se nuk ka asnjë lloj pretendimi ligjor dhe financiar kundrejt z. J. G. ”. Për sa më sipër del se nuk ka pasur detyrim financiar në kohën e përpilimit dhe nënshkrimit të deklaratës, pasi detyrimet ishin shlyer. Dakordësimi për revokimin e kontratës del qartë pasi, akti është diskutuar dhe dakordësuar më parë dhe më pas është nënshkruar. Kjo është bërë në mënyrë verbale mes palëve më parë dhe më pas në mënyrë formale me Akt Revokimi.

- Mënyra e likuidimit nuk është shprehur në aktin e revokimit, por duke u bazuar në Akt Marrëveshjen ku përcaktohet mënyra e likuidimit dhe likuidimit faktik (kalimin e vlerës në llogari) pas Revokimit, duke deklaruar se nuk ka asnjë lloj pretendimi ligjor dhe financiar kundrejt z. J. G. , del qartë edhe mënyra e likuidimit, që është bërë në të njëjtën mënyrë.” Shlyerja Kesh është bërë në total, në kohën e shlyerjes në llogarinë bankare (06.12.2011). Si datë fikse, subjekti shprehet se nuk i kujtohet, por mund të ketë qenë nga datat 06-14.12.2011. Kjo vlerë është depozituar më vonë në llogarinë e BKT (rreth muajit Shkurt).

83. Në përfundim të hetimit të kryer mbi bazë dokumentacioni dhe korrespondencës me subjektin e vlerësimit, Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, konstaton se:

- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me qëllimin e marrjes dhe të përdorimit të kredisë bankare.**
Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijjen e Raiffeisen Bank, lidhur me detyrimin e mbetur të kredisë.

- ✓ **Subjekti nuk disponon dokument (mandat arkëtimi/pagese) në momentin e likuidimit cash nga ana e shoqërisë kundrejt subjektit për revokimin e kontratës nga palët; por likuidimi është depozituar më vonë nga subjekti në llogarinë e BKT.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- A. Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.**

84. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- 1) Shpenzime për ujë, në vlerën 11.907 lekë.
- 2) Shpenzime për drita, në vlerën 37.917 lekë.
- 3) Shpenzime për telefon fiks numër 05****, në vlerën 12.000 lekë. Telefon celular numër: 06941***, 069****5, 069****8, 068****3, vlera 26.400 lekë.
- 4) Shpenzime për internet në vlerën 12.000 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

85. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit si dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse, nga ku rezulton se:

85.1 Referuar librezës për furnizimin me ujë, për kontratën nr. ***, në emër të Lorenc Panganika, shpenzimet për konsum uji për vitin 2022, janë në vlerën 11.907 lekë.

85.2 Sipas librezës për energji elektrike për kontratën nr. ***, në emër të Lorenc Panganika, shpenzimet për vitin 2022, janë në vlerën 37.917 lekë.

85.3 Sipas librezës nga Internet Sky Elbasan, në emër të Lorenc Panganika, shpenzimet për Prill 2022 - Dhjetor 2022, janë në vlerën 9.000 lekë.

85.4 Sipas faturave tatimore të shitjeve, për telefonin fiks nr. 05****, në emër të Lorenc Panganika, shpenzimet për periudhën Janar 2022 - Nëntor 2022, në vlerën 11.129 lekë.

86. **FSHU** me shkresën nr. *** prot., datë 19.05.2023, referuar sistemit të faturimit, konfirmon se në emër të Lorenc Panganika ka një kontratë furnizimi nr. EL****07, në instancën Elbasan. Sipas faturave përmbledhëse, shpenzimet për periudhën 16.01.2022 - 26.12.2022, janë në vlerën 3 7.451 lekë.

87. **Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Lorenc Panganika ka një kontratë furnizim nr. ***, me vendndodhje lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, Rruga “Thoma Kalefi”. (Bashkëlidhur praktika). Referuar faturës për konsum për periudhën Janar 2022 - Dhjetor 2022, shpenzimet janë në vlerën 11.663 lekë.

88. **Vodafone Albania**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2023, konfirmon se për numrat 06941***, 069***5, 069***8, është bërë kalimi i pronësisë së tyre nga Lorenc Panganika në emër të Drejtorisë së Policisë Vendore Korçë.

- Shpenzimet për vitin 2022, janë në vlerën 20.400 lekë.

89. Në proces verbalin e datës 12.09.2023, subjekti paraqiti shpjegime lidhur me numrat celularë të konstatuar. Numri celular 069***4 përdoret nga nëna e bashkëshortes dhe shpenzimet për vitin 2022 për këtë numër, janë në vlerën rreth 4.000 lekë.

90. **One Albania sh.a**, me shkresën nr. ** prot., datë 31.05.2023, konfirmon se në emër të Lorenc Panganika, rezulton i regjistruar numri fiks +355542****. *Bashkëlidhur tabela përmbledhëse me të dhënat e klientit.* Për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022 është paguar shuma 11.254 lekë.

91. **Albania Satellite Communications shpk, Abissnet sh.a dhe Digicom sh.a**, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

92. Në përfundim të verifikimeve të kryera, Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijien e FSHU, UKT.**
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefon, internet etj., gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 100.000 lekë.**

B. Shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

93. Subjekti ka deklaruar: Udhëtim në Kosovë për arsye shërbimi, me urdhër nr. 1259, datë 25.10.2022, “Për dërgim me shërbim jashtë shtetit”.

Objekti: Pjesëmarrje në Konferencën e 42-të, të Policive të Kryeqyteteve Evropiane. Qëndrimi në Prishtinë në hotel “Emerald”. Ditë qëndrimi nga data 26.10.2022 deri më datë 28.10.2023. Nuk ka shpenzime, pasi janë rimbursuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

HETIMI ADMINISTRATIV

94. Trupa e vlerësimit verifikoi dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës nga subjekti, konkretisht urdhrin nr. 1259, datë 25.10.2022, nga DPPSH, ku rezulton se drejtuesi Lorenc Panganika, ka shkuar për shërbim jashtë shtetit për periudhën 26.10.2022 - 28.10.2022, në Prishtinë Kosovë. Sipas faturës së qëndrimit në hotel Emerald dhe mandat pagesës nr. ***, datë 10.11.2022, shpenzimet për këtë udhëtim janë në vlerën 472 euro.

95. Subjekti nuk ka deklaruar udhëtime të tjera të tij dhe/ose personave të lidhur me të, për periudhën e përcaktuar në formularin e deklaratës së pasurisë. Në proces verbalin e datës 12.09.2023 subjekti paraqiti shpjegime, ku sqaroi se ai dhe anëtarët e familjes, nuk kanë udhëtuar privatisht, nga data 01.01.2020 deri 31.12.2022. Udhëtimi në Kosovë, nga data 26.10.2022 - 28.10.2022 është bërë për arsye pune. Pjesëmarrja e bashkëshortes është bërë me ftesë nga organizatorët, ku çdo pjesëmarrës mund të shkojë edhe me bashkëshorten dhe shpenzimet mbulohen nga institucioni dhe organizatorët.

96. Referuar sistemit TIMS rezulton:

- Lorenc Paganika:
Datë dalje 18.07.2017 - datë hyrje 23.08.2017.
Gjithashtu ka hyrje dhe dalje në rrugë tokësore dhe ajrore gjatë periudhës 2004 – 2019.
- Entela Paganika:
Datë dalje 27.09.2012- date hyrje 18.12.2012.
Datë dalje 18.07.2017 - datë hyrje 23.08.2017.
Gjithashtu ka hyrje dhe dalje në rrugë tokësore dhe ajrore gjatë periudhës 2004 – 2019.
- Kelvi Paganika:
Datë dalje 27.09.2012 - datë hyrje 18.12.2012.
Datë dalje 18.07.2017 - datë hyrje 23.08.2017.
- Noel Paganika:
Datë hyrje 18.12.2012.
Datë dalje 18.07.2017 - datë hyrje 23.08.2017.

97. Në procesverbalin e datës 12.09.2023, subjekti sqaroi se djali ka lindur në Kanada. Ka qëndruar tek motra e bashkëshortes M. G. Shpenzimet vajtje-ardhje në Kanada, të bashkëshortes Entela Paganika dhe djalit Kelvi Paganika në vitin 2012 dhe familjarisht në Korrik - Gusht 2017, janë financuar nga kunata dhe bashkëshorti i saj, në shumën rreth 6.300 dollarë kanadez, me burim të ardhura të tyre familjare nga puna në Kanada, pasi jetojnë e punojnë në Kanada që nga viti 2005.

97.1Ndërsa shpenzimet mjekësore për lindjen e djalit Noel Paganika janë kryer nga të ardhurat familjare, në shumën 4.912 dollarë kanadezë. Gjithashtu, subjekti sqaroi se bashkëshortja ka marrë dhurata për lindjen e djalit Noel, në vitin 2012 në Kanada, në vlerën rreth 10.000 dollarë kanadezë, të cilat i janë dhuruar nga të afërm të saj, konkretisht:

- 6.500 dollarë kanadez nga M. M. (vajza e xhaxhait) e cila banon në Kanada;
- 2.000 cad, nga A. M. (djali i xhaxhait) i cili jeton në USA;
- 1.000 usd nga A. K. (e afërme e bashkëshortes) që jeton në USA;
- rreth 500 dollarë janë dhuruar nga miq me të cilët kanë marrëdhënie familjare (që jetojnë në Kanada).

97.2Në lidhje me shpenzimet e kryera për udhëtimet në Kanada, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, nga ku rezulton:

- Konfirmohet se në datën 27.07.2012 është paguar vlera 288 usd nga H. G. për biletat e udhëtimit të Noel Panganika. (e-mail nga eticket@alitalia.it)
- Konfirmohen pagesat e biletave vajtje - ardhje për Entela Panganika dhe Kelvi Panganika, në vlerën 1.809 usd. (dokumentacion në gjuhë angleze)
- Shpenzimet nga Entela Panganika në “Humber River Regional Hospital”, për periudhën 25.10.2012 - 31.10.2012, janë në vlerën rreth 4.912 dollarë kanadez. (dokumentacion në gjuhë angleze).
- Shpenzimet e paguara “Thy Airline”, për udhëtimin në Kanada të familjes “Panganika”, nëpërmjet rrugës ajrore, kthimi në datë 22.08.2017, Kanada - Stamboll - Tiranë, nga H. G. më datë 16.02.2017, janë në vlerën 4.215 dollarë kanadezë, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare për periudhën 16.02.2017 - 17.03.2017, pranë Royal Bank, në emër të H. G.

98. Në mbështetje të deklarimeve të kryera nga ana e tij, subjekti ka përcjellë deklarata të familjarëve të bashkëshortes të cilët u kanë dhuruar vlera monetare, kryesisht për lindjen e djalit Noel Panganika në Kanada dhe konkretisht:

- a. Deklaratë datë 27.07.2023, nga M. G.dhe H. G., të cilët deklarojnë se kanë mbuluar shpenzimet e udhëtimit të biletave të avionit, të Entela, Klevi dhe pas lindjes Noel Panganika, për udhëtimin e tyre në Kanada, në vitin 2012 dhe 2017. Entela Panganika, së bashku me familjen e saj, ka jetuar në banesën e tyre gjatë kohës së qëndrimit në Kanada, për periudhën Shator - Dhjetor 2012 dhe për periudhën Korrik - Gusht 2017. Deklarojnë se kanë qenë të pranishëm në dhënien e dhuratave nga të afërm dhe miq që jetojnë në Kanada, për lindjen e djalit Noel, në datë 08.11.2012, përkatësisht shtetasit A. M., M. (Mitrollari) K., A. E., N. T., A. G., M. Gj., I. B., etj.

99. Në mbështetje të deklarimeve të kryera nga ana e tij, subjekti ka përcjellë deklarata të familjarëve të bashkëshortes të cilët u kanë dhuruar vlera monetare, kryesisht për lindjen e djalit Noel Panganika në Kanada; ku secili prej deklaruesve ka bashkëlidhur dhe dokumentacion në gjuhën angleze, për kthimin e taksave që vërteton të ardhurat bruto/neto për vitin 2012 dhe 2017.

100. Në përfundim të hetimit të kryer mbi shpenzimet për udhëtime të subjektit dhe personave të lidhur me të, Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet e udhëtimit, për periudhën 2020 - 2022, ku ka rezultuar vetëm një udhëtim për shkak të detyrës.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet për lindjen e djalit në Kanada në vitin 2012, në shumën rreth 6.300 dollarë kanadez, (afërsisht 688.800 lekë) si dhe dhuratat e përfituara nga të afërm të bashkëshortes në shumën rreth 10.000 dollarë kanadez. (10.000 cad * 109.33 lekë/cad = 1.093.300 lekë)¹.**
- ✓ **Subjekti ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumentacion për shpenzimet shëndetësore për lindjen e djalit në Kanada, në vlerën rreth 4.900 dollarë kanadez, në vitin 2012. (afërsisht 535.735 lekë, sipas kursit mesatar të këmbimit për muajin Nëntor 2012.)**

¹ Referuar kursit mesatar të këmbimit për muajin Nëntor 2012- Arkiva e Kursit të Këmbimit (Banka e Shqipërisë).

C. Shpenzime për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

101. Subjekti nuk ka deklaruar shpenzime për arsimin e fëmijëve.

HETIMI ADMINISTRATIV

102. Në proces verbalin e datës 12.09.2023, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim se ai dhe personat e lidhur, nuk kanë kryer shpenzime për shkollimin. Fëmijët kanë studiuar gjithmonë në shkollën publike Luigj Gurakuqi, Elbasan. Subjekti paraqiti vërtetime datë 25.07.2023 që konfirmojnë ndjekjen e mësimave të fëmijëve në këtë shkollë.

✓ Subjekti ka dhënë shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues, në lidhje me shkollimin e fëmijëve në shkolla publike.

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR, ENTELA PANGANIKA (BASHKËSHORTJA E SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT)

DEKLARIMI I PASURIVE

- 1) **Llogari rrjedhëse individuale**, me numër llogarie *****, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me balancë në vlerën **70.429 lekë**.
Pjesa takuese 100%.
Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga dhe angazhime të tjera (workshop, seminare, konferenca).
- 2) **Llogari rrjedhëse individuale**, me numër llogarie *****, pranë Raiffeisen Bank, me balancë në vlerën **252.623 lekë**.
Pjesa takuese 100%.
Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si anëtare e Komisionit Mjekësor për caktimin e aftësisë në punë, dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan.

HETIMI ADMINISTRATIV

103. **BKT** me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Entela Panganika ka llogari rrjedhëse me balancë, në datë 01.03.2023, në vlerën 70.429 lekë.

104. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Entela Panganika ka llogari page, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 239.873 lekë. Bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë bankare.

✓ Konfirmohet deklarimi me përqijqjen e BKT mbi llogarinë e paqës në emër të E. P.

✓ **Konfiromohet llogaria e deklaruar nga bashkëshortja me përgjiqjen e Raiffeisen Bank.**

- 3) **Dëshmi trashëgimie ligjore**, datë 11.06.2021. Shënim: Vendim për lëshimin e Dëshmisë se Trashëgimisë Ligjore, nr. rep. ****, nr. kol. ***, datë 11.06.2021, me anë të së cilës jam përfituese si trashëgimtare ligjore e radhës së parë, së bashku me nënën V. M dhe motrën M. G. (M). Vetëm pas pjesëtimit të pasurisë, mund të bëhet deklarimi nga ana ime, i pjesës takuese të pasurisë.

HETIMI ADMINISTRATIV

105. **Referuar Vendimit për lëshimin e dëshmisë trashëgimore**, nr. ****, datë 11.06.2021, rezulton se pas vdekjes së bashkëshortit P. M., shtetasja V. M ka kërkuar çeljen e trashëgimisë ligjore dhe trashëgimtarët ligjorë janë V. M, M. G. (Mitrollari), Entela Panganika (Mitrollari).

105.1 **Referuar nxjerrjes së llogarisë bankare pranë BKT**, përcjellë me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, evidentohet se janë kredituar 2 shuma me përshkrimin “*P. Mitrollari për Entela Panganika sa kaluar pjesa takuese 1/3 sipas akt trashëgimie nr. **, datë 11.06.2021*”, si vijon:

- a. Në datë 14.05.2022 është kredituar vlera 942.626 lekë.
- b. Në datë 10.01.2023 është kredituar vlera 2.010.452 lekë.

105.2 **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën datë 04.07.2023, konfirmon se Entela Panganika ka në bashkëpronësi pasurinë nr. ***, vol.** faqe **, ZK 8521, e llojit apartament, me sipërfaqe 83 m², duke bashkëlidhur:

- a) Vendim për lëshim të dëshmisë trashëgimore.
- b) Kartelën e pasurisë së paluajtshme të apartamentit të cituar.
- c) Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. 41-49, datë 23.01.2004. Harta treguese e regjistrimit të apartamentit, me sipërfaqe 68 m².

106. I pyetur në lidhje me trashëgiminë ligjore të bashkëshortes të konfirmuar nga ASHK, nëpërmjet proces verbalit të datës 12.09.2023, subjekti paraqiti shpjegime se bashkëshortja e tij përfiton nga trashëgimia ligjore 1/6 pjesë, ashtu sikurse motra e saj. Transferimet monetare në BKT, nga llogaria e babait të saj P. M., në shumat 942.626 lekë dhe 2.010.452 lekë, janë kthyer në llogari nënës së saj, pasi bashkëshortja Entela Panganika ka hequr dorë nga pjesa takuese në lidhje me likuiditetet që rrjedhin nga trashëgimia. Sqaron se burimi i obligacioneve në BKT, në emër të babait, është nga kursimet familjare të prindërve të bashkëshortes. Subjekti ka shtuar se bashkëshortja përfshihet në autorizim për përdorim të llogarive bankare të motrës, nëse nëna e saj V. M, ndodhet në pamundësi për të kryer veprime apo ndahet nga jeta.

107. Krahas shpjegimeve me shkrim, subjekti paraqiti dokumentacion justifikues në lidhje

me pasurinë e bashkëshortes, si më poshtë vijon:

- a. Praktika e privatizimit e apartamentit në rrugën “Konferenca e Labinotit”, në emër të A. M.. Harta treguese e regjistrimit.
 - b. Kontratë shitblerje nr. ***, datë 17.01.2004, me palë shitëse Gj. M., J. M., A. M. dhe E. M. dhe palë blerëse P. Mitrollari, ku pala shitëse është pronare e 1/15 pjesë, së bashku me 6/15 pjesë të palës blerëse të pasurisë apartament 2+1, me sipërfaqe 68 m², kundrejt çmimit 200.000 lekë dhe P. M. bëhet pronar me 10/15 pjesë të apartamentit dhe V. Sh. ka 5/15 pjesë të kësaj pasurie.
 - c. Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. 41-49, datë 23.01.2004, nga ZVRPP Elbasan, në emër të P. M. dhe V. M, të pasurisë në ZK 8521, me sipërfaqe 68 m².
 - d. Certifikatë regjistrim pronësie, nga ASHK, në datën 13.07.2021, në emër të V. M, e cila ka në zotërim 4/6 pjesë të apartamentit me sipërfaqe 83 m², me nr. ***, në rrugën “Konferenca e Labinotit”, nd. **, ap. **. Kartela e pasurisë së paluajtshme, ku Entela Panganika përfiton 1/6 pjesë të pasurisë.
 - e. Vërtetim datë 25.07.2023, nga ASHK DV Elbasan, që vërteton se në emër të V. M. figuron e regjistruar pasuria nr. ***, në ZK 8521, e llojit apartament me sipërfaqe 83 m², Elbasan. Këtë pasuri e ka në bashkëpronësi me M. G. dhe E. Panganika, ku këto të fundit zotërojnë 1/6 pjesë. Kjo pasuri ka qenë e regjistruar në radhorin nr. **, datë 23.01.2004, me numër pasurie ***, ZK 8521, me adresë lagjja “Konferenca e Labinotit”, Elbasan, me sipërfaqe 68 m². Kur ka përfunduar procedura e regjistrimit të ZK 8521, Elbasan dhe është bërë hapja e kartelave të pasurisë, pasuria e llojit “Apartament”, saktësimi i sipërfaqes sipas kontratë privatizimi, kjo pasuri figuron me sipërfaqe 83 m² dhe jo 68 m², ashtu siç figuron në radhorin e pronësisë.
 - f. Nxjerrje llogari bankare, datë 13.06.2023, në BKT, në emër të P. M., ku në datën 17.05.2022 është transferuar vlera prej 942.626 lekë, në llogari të Entela Panganika, me përshkrimin “P. Mitrollari për Entela Panganika sa kaluar pjesa takuese 1/3 sipas akt trashëgimie nr. 1283/419, datë 11.06.2021”. Në këtë llogari është debituar e njëjta vlerë, e cila ka kaluar në llogari të V. M (bashkëshortes) dhe V. M me prokurën e M. G. (vajza), datë 20.10.2021.
 - g. Prokurë datë 20.10.2021, ku shtetasja M. G., emëron mamanë saj V. M. të kryejë veprime në llogarinë e saj. Nëse mamaja V. M., është në pamundësi fizike, mendore, etj., veprimet të kryhen nga Entela Panganika (Mitrollari).
 - h. Nxjerrje llogari bankare në emër të P. M., në BKT, datë 20.06.2023, ku në datën 10.01.2023, është transferuar vlera prej 2.010.452 lekë, në llogari të Entela Panganika. Gjithashtu e njëjta vlerë ka kaluar në llogari të V. M (bashkëshortes) dhe V. M me prokurë nga M. G. (vajza).
 - i. Nxjerrje llogari bankare, datë 14.06.2023, në BKT, në emër të P. M., ku në datën 28.03.2017, vlera 8.000.000 lekë është investuar për obligacione 10 vjeçare.
108. Në inventarin e datës 06.11.2023 subjekti paraqiti deklaratë noteriale datë 03.11.2023, me deklaruese Entela Panganika, ku me vullnetin e saj heq dorë nga pasuria e luajtshme duke përfshirë edhe çdo depozitë dhe të ardhur bankare të trashëgimlënësit P. Mitrollari.

109. Në përfundim të hetimit të kryer, nga sqarimet me shkrim të subjektit dhe dokumentacioni justifikues të përcjellë, rezulton se:

Bashkëshortja e subjektit, me Dëshminë e Trashëgimisë Ligjore, datë 11.06.2021, është përfituese si trashëgimtare ligjore me 1/3 pjesë takuese, në pasuritë në emër të babait të saj, P. M.. Konkretisht, përfiton 1/6 pjesë të apartamentit me sipërfaqe 83 m², në lagjen “Konferenca e Labinotit”, Elbasan, dhe 1/3 e gjendjeve në llogarinë e babait në BKT, ku bashkëshortja me vullnetin e saj, ia transferon pjesën prej rreth 2.953.00.000 lekë, nënës V. M, duke paraqitur edhe deklaratë noteriale për këtë fakt.

- ✓ **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, konfirmon se Entela Panganika zotëron 1/6 pjesë të pasurisë apartament me sie. 83 m², nga trashëgimia ligjore e babait të saj.**
- ✓ **Likuiditetet në BKT në emër të Entela Panganika janë kthyer në llogari të nënës së saj.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- 1) **Të ardhura nga paga në Qendrën Spitalore Elbasan.** Vlera 9.220.019 lekë.
- 2) **Të ardhura nga paga si anëtare në Komisionin Mjekësor** për caktimin e aftësisë për punë, dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan. Vlera 605.625 lekë.
- 3) **Të ardhura nga veprimtari të dyta e private**, si workshop, seminare, konferenca firma farmaceutike Ëin Farma shpk, Deltapharma, Bilimim Ilac San VeTic A.S., Zentiva Pharma etj. Vlera 1.402.958 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

110. Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 13.04.2018 dhe vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Rajonale Elbasan, konfirmohen të ardhurat nga paga të Entela Mitrollari, për periudhën 16.09.2004 - 28.02.2007, në vlerën 709.584 lekë. *Bashkëlidhur tabela përmbledhëse e të ardhurave të llogaritura për Entela Panganika, për periudhën 19.06.2004 - 28.02.2023.*
111. Referuar nxjerrjes së llogarisë bankare në emër të Entela Panganika, përcjellë nga **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, për periudhën 02.04.2019 - 01.03.2023, është kredituar shuma prej 592.880 lekë.
112. **BKT** me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari page në emër të Entela Panganika, ku i kreditohet paga nga Spitali i Rrethit Elbasan, Delta Pharma, Win Farma, Bilimim Ilac San VeTic, Zentiva Pharma, për periudhën 17.02.2012 - 01.03.2023, në vlerën 8.175.081 lekë.
113. **Credins Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari page në emër të Entela Panganika, ku i kreditohet paga për periudhën Shkurt 2007 - Gusht 2011, në vlerën 1.700.529 lekë.

114. **ISSH** me shkresën nr. ** prot, datë 10.5.2023, konfirmon se Entela Panganika përfiton të ardhura ngapunësimi pranë subjekteve “Spitali i Rrethit, Spitali Rajonal Elbasan” për periudhën Janar 2012 - Mars 2023.
115. **ISSH** me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, i kërkon Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër që të dërgohet informacion pranë ILDKPKI, për periudhën para vitit 2012, për shtetasin Lorenc Panganika dhe familjarët e tij.
- ✓ **Të ardhurat neto të bashkëshortes nga paga, shpërblimet, etj., për periudhën Shtator 2004 - Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 11.178.000 lekë.**

DETYRIME FINANCIARE

116. **Kredi bankare në Raiffeisen Bank për banesë.** Nga data 25.10.2011 deri më datë 31.10.2031. Shuma totale 2.500.000 lekë, kohëzgjatje në muaj 240. Shuma e detyrimit të mbetur 1.087.168 lekë.
- ✓ **Trajtuar më lart.**

REZULTATE TË TJERA GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV TË KRYER:

117. **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari master card të çelur në datën 30.03.2016, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 0 euro. Gjithashtu ka llogari rrjedhëse, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 1.75 euro. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare.
118. **Tirana Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka pasur llogari bankare në monedhën lekë, e cila është mbyllur në vitin 2014. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare.
119. Në lidhje me veprimet e konstatuara në Tirana Bank, në proces verbalin e datës 12.09.2023, si dhe në përgjigjet nëpërmjet email-it me relatoren e Trupës së Vlerësimit, sqaroi se transaksionet që i përkasin periudhës 2011- 2013, nuk i kujtohen të gjitha për shkak të kohës së gjatë por mendon se kanë lidhje me transaksionet (tërheqjet dhe depozitat) në BKT dhe Tirana Bank për vitet 2012, 2013, 2014.
Burimi i krijimit të tyre është nga të ardhurat familjare të krijuara në vite, interesat dhe kthimi i vlerës 4.000.000 lekë, nga Shoqëria “A**-G** shpk”, në datë 06.12.2011, nga revokimi i marrëveshjes.
- 119.1 Gjithashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 19.04.2024, subjekti dha sqarime mbi vlerën 4.000.000 lekë (1.500.000 lekë + 2.500.000 lekë) **(trajtuar më sipër.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me transaksionet bankare në Tirana Bank dhe burimin financiar.**

✓ **Konfirmohet deklarimi me veprimet bankare.**

120. **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika ka llogari rrjedhëse me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 49 euro dhe 0 euro. Gjithashtu, ka llogari kursimi, me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 15 euro dhe depozitë me balancë në datë 01.03.2023, në vlerën 0 euro.

a. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare rrjedhëse nr. 4***9, ku janë konstatuar veprime të trajtuara më sipër (deklarimi i pasurisë dhe i të ardhurave të subjektit); si dhe veprime të tjera si vijon:**

- Në datë 22.11.2017, transferuar vlera 330.000 lekë, me përshkrimin “Lorenc Panganika për P. Mitrollari, kthim borxhi”.
- Në datë 18.06.2021, transferuar shuma 5.475.000 lekë, me përshkrimin “kalim fondi”.
- Në datë 22.04.2022, kjo llogari rezulton e mbyllur.

b. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare nr. 4***9,(depozitë) ku konstatohen veprime trajtuara më lart, si dhe veprime të tjera për të cilat subjekti ka dhënë sqarimet përkatëse.**

- Në datë 11.06.2014, depozituar vlera 1.100.000 lekë nga G. Panganika, kthim borxhi.
- Në datë 13.06.2014, çelur depozitë bankare në vlerën 4.242.707 lekë.
- Në datë 19.05.2015, transferuar vlera 500.000 lekë nga G. Panganika, kthim borxhi.
- Në datë 22.05.2015, transferuar vlera 700.000 lekë nga P. M.
- Në datë 22.05.2015, çelur depozita në vlerën 5.000.051 lekë.
- Në datë 15.06.2015, maturuar depozita në vlerën 4.289.570 lekë, tërhequr cash.
- Në datë 26.10.2015, depozituar cash vlera 3.500.000 lekë, e cila ka kaluar në depozitë bankare.
- Në datë 29.05.2017, maturuar depozita dhe kaluar vlera 3.546.005 lekë, ku janë kredituar interesa në vlerën rreth 382.500 lekë dhe transferuar vlera 3.927.509 lekë në llogari në BKT.
- Në datë 22.05.2020, maturuar depozita në vlerën 5.000.051 lekë, ku janë kredituar interesa në vlerën 574.073 lekë. Shuma 5.477.715 lekë ka kaluar në llogari rrjedhëse. Llogaria rezulton e mbyllur.

c. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare nr. 4**9, në monedhën euro, ku konstatohen veprimet si më poshtë:**

- Në datë 16.08.2011 është kredituar llogari në vlerën 27.000 euro nga E. I., shumë e cila ka kaluar në depozitë bankare në datë 17.08.2011.
- Në datë 26.12.2012, depozituar vlera 4.000 euro, e cila ka kaluar në depozitë bankare.
- Në datë 20.11.2012, maturuar depozita bankare në vlerën 27.124 euro, ku shuma 26.130 euro është tërhequr cash.
- Në datë 26.12.2012 është maturuar depozita në vlerën 4.012 euro dhe transferuar shuma 5.006 euro nga llogaria në depozitë bankare. Llogaria rezulton e mbyllur.

d. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare nr. 4*9, në monedhën euro, ku konstatohen veprimet si më poshtë:**

- Në datë 30.10.2013, çelur depozitë bankare në vlerën 10.583 euro.
- Në datë 08.08.2014, çelur depozitë bankare në vlerën 13.627 euro, pas depozitimit të shumës 3.000 euro. Maturimi i depozitës është bërë në datën 27.08.2015.
- Në datën 27.05.2015, kredituar llogaria në vlerën 26.000 euro, depozitim cash nga Lorenc Panganika.
- Në datë 27.08.2015, çelur depozita në vlerën 40.000 euro, (13.000 euro + 26.000 euro).
- Në datë 28.05.2019, maturuar depozita në vlerën 40.162 euro. Llogaria mbyllet në datën 28.05.2019, pas transfertes në vlerën 8.162 euro dhe tërheqja cash e shumës 31.995 euro.

e. Bashkëlidhur: Nxjerrje llogari bankare nr. 4***, ku konstatohen veprimet si më poshtë:**

- Në datë 05.06.2019, depozituar vlera 32.000 euro.
- Në datë 05.06.2019, shuma 44.161 euro ka kaluar në llogari kursimi.
- Në datë 04.09.2019 është transferuar vlera 44.000 euro, në llogari të A****M, shpk., për blerje apartamenti me kontratë porosie.
- Në datë 24.04.2020, transferuar shuma 6.000 euro, me përshkrimin “Kalim sipas kontratë porosie (porosi garazh) nr. 2164/863, datë 23.04.2020, të A****M shpk”.
- Në datë 05.11.2020 është kredituar llogaria në vlerën 50.000 euro nga A*** - 2M sa kalon në llogari të Lorenc Panganika për revokim kontratë nr. ***, datë 30.10.2020. Shuma e cila kalon në depozitë në datën 22.01.2021.
- Në datë 29.10.2021 është maturuar depozita në vlerën 50.011 euro.

121. **BKT**, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari të çelur në datë 09.05.2012, në monedhën euro, në emër të Entela Panganika ku konstatohen veprimet si më poshtë shënuar:

- Në datën 09.05.2012, depozituar vlera 20.000 euro, ku shumat nga 10.000 euro janë tërhequr në datën 18.05.2012 dhe 21.05.2012. Llogaria është mbyllur në datë 28.12.2013.

a. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare page të Entela Panganika, ku konstatohen tre transferime bankare në llogari të bashkëshortit, konkretisht më datë 29.05.2017, 18.06.2021 dhe më datë 31.01.2023.

HETIMI ADMINISTRATIV

122. Në procesverbalin e datës 12.09.2023 drejtuar ILDKPKI-së, si dhe kthim-përgjigjet drejtuar Relatores së çështjes nëpërmjet e-mailit të datës 06.02.2024, për gjetjet e sipërcitura, subjekti paraqiti shpjegime si më poshtë vijon:

122.1 Në lidhje me të gjitha transaksionet në BKT në llogarinë e tij dhe të bashkëshortes për periudhën 2011 - 2023, sqaroi se **burimi i tyre** janë kursimet nga të ardhurat familjare nga

pagat, dhurata për lindjen e djalit, interesat bankare, kredi të marra si dhe kthimi i tyre, shitje e pasurive të luajtshme, si dhe huatë afatshkurtra nga vjehri dhe kthim borxhi nga vëllai G.P. në vitin 2014 dhe në vitin 2015. Me qëllim përfitimin e interesave sa më të larta, këto likuiditete kanë kaluar në bankat e nivelit të dytë, konkretisht Tirana Bank, BKT dhe Raiffesien Bank, si dhe kryesisht investimin në obligacione.

123. Përsa i përket të ardhurave dhe kthimit të borxhit nga vëllai i tij G.P., Trupa e Vlerësimit, kreu hetimin administrativ bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit dhe institucionet ligjzbatuese, si më poshtë shënuar:

123.1 Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.07.2023, me deklarues G.P., i cili ka deklaruar se ushtron veprimtari private, librari, në qytetin e Elbasanit. Për shkak të aktivitetit të tij në periudha të ndryshme, ka marrë nga vëllai i tij, Lorenc Panganika, shuma të ndryshme në të cilat janë përdorur për veprimtari dhe privatizimin e objektit librari, para vitit 2013. Në datë 11.06.2014, i ka kthyer vëllait shumën 1.100.000 lekë dhe në datën 19.05.2015, i ka kthyer shumën 500.000 lekë, në total 1.600.000 lekë. Për shkak të marrëdhënies familjare dhe vlerave në shuma të ndryshme, nuk kanë përpiluar akt noterial. Kopje ID-ve.

123.2 Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ** prot., datë 13.06.2023, nga ISSH, në emër të G.P., për periudhën Janar 2012 - Prill 2023, i cili ka qenë i punësuar pranë “Gama Security, G.P.”

123.3 Vërtetim për bazën e vlerësueshme datë 13.06.2023, në emër të G.P., për të ardhurat nga punësimi pranë shoqërisë “***” për periudhën Qershor 2002 - Prill 2007. Vërtetim për bazën e vlerësueshme datë 13.06.2023, në emër të G.P., ka realizuar të ardhura nga punësimi pranë shoqërisë “Gama Security”, për periudhën Shkurt 2008 - 31.12.2011.

123.4 **QKB**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.07.2023, konfirmon se G.P. figuron i regjistruar si person fizik, me NIPT L*****N, me status aktiv, si dhe G.P. figuron i regjistruar si person juridik “Gama Security” shpk, me NIPT *****, me status çregjistruar. Bashkëlidhur: Kopje të ekstrakteve historike.

123.5 **DRT Elbasan**, me shkresat nr. ***, datë 14.07.2023 dhe shkresat ***, datë 31.07.2023, konfirmon se G.P. figuron i regjistruar si person fizik me NIPT L*****N, me datë regjistrimi 01.12.2015. Subjekti nuk ka detyrime në kohë reale deri në datë 10.07.2023. Bashkëlidhur: Deklarata e tatimit të thjeshtuar të fitimit për periudhën 2015 -2019.

123.6 Gjithashtu, G.P. figuron i regjistruar si person juridik “Gama Security” shpk., me NIPT K*****, me status të çregjistruar. Bashkëlidhur:

- i. Deklarata e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël 2008 – 2012.
- ii. Deklaratat e tatimit të thjeshtuar të fitimit për periudhën 2014 – 2015.

124. Për sa i përket llogarive të sipërcituara, subjekti ka sqaruar se kanë kaluar fonde për prenotim apartamenti pranë shoqërisë Emir shpk., në vitin 2011, shuma 26.000 euro,

kontratë e cila revokohet në vitin 2015 dhe shuma kthehet përsëri në BKT.
Në lidhje me këtë transaksion subjekti paraqiti:

- a. Akt Marrëveshje e datës 20.12.2011, nëpërmjet Shoqërisë “Ermir” dhe Lorenc Panganika, ku, Shoqëria “Ermir”, me NIPT K*****Q, ka aktivitet shitblerje materiale ndërtimi dhe marrëdhënie biznesi me shoqëri dhe firma ndërtimi, ku nga furnizimi i këtyre të fundit, likuiditeti kryhet me bankë, cash ose mund të përfitojë sipërfaqe ndërtimi në këmbim të tyre. Në këtë kuadër, shtetasi Lorenc Panganika ka depozituar në arkën e shoqërisë Ermir shumën prej 26.000 euro, si parapagim për pronotim apartamenti. Pas sigurimit të një apartamenti me pëlqimin edhe dakordësinë e palëve do të lidhet dhe kontratë paraprake pronotimi.
- b. Certifikatë e regjistrimit të shoqërisë.
- c. Mandat arkëtimi datë 20.12.2011 nga Lorenc Panganika, të shumës 26.000 euro.
- d. Zgjidhje Akt-Marrëveshje datë 29.08.2015, në zyrat e shoqërisë E*** shpk., ku palët Lorenc Panganika dhe H. D., administrator i shoqërisë, bien dakord për zgjidhjen marrëveshjes së datës 20.12.2011. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, shoqëria Ermir shpk i kthen shumën 26.000 euro shtetasit Lorenc Panganika, në të njëjtën mënyrë.
- e. Dokumentacion i shitjeve të shoqërisë “E****” shpk., për periudhën 2010 - 2017, deklaruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

125. Nga nxjerra e llogarisë bankare në emër të Lorenc Panganika si dhe dokumentacioni i përcjellë, Trupa e Vlerësimit vëren se në dokumentat e dorëzuar nga subjekti, pra akt-marrëveshja e datës 20.12.2011 me shoqërinë E*** shpk. dhe zgjidhja e akt-marrëveshjes datë 29.08.2015, mungojnë elementët e një akti të mirëfilltë juridik, ku të shprehen qartë objekti, detyrimet, të drejtat e palëve, mënyrat e kryerjes së pagesës, etj. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, kthimi i shumës 26.000 Euro duhet të jetë i shoqëruar me mandatin përkatës të lëshuar nga shoqëria “E**** shpk”, pra në të njëjtën mënyrë që është kryer dhe parapagimi në arkë nga subjekti i vlerësimit.

125.1 Në lidhje me këto konstatime, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim se:

- *Vlera është depozituar në arkë me mandate, me marrëveshje Jo-formale (pa akt noterial) firmës “Ermir”, 26.000 euro për parapagim për blerje apartamenti. Kjo, për arsye se shoqëria “Ermir” kryente shitje të materialeve të ndërtimit me shumicë shoqërive/firmave të ndërtimit dhe nuk ka pasur një objekt konkret për pronotim apartamenti, por gjatë shitjeve në vijim në rast se do shihej ndonjë opsion i mirë për pronotim apartamenti, do bëhej me Akt Marrëveshje apo Prenotimi me akt noterial.*
- *Tërheqja e shumës 26.000 euro është bërë në arkën e kësaj shoqërie me mandate (në të njëjtën mënyrë si derdhja e shumës) por nga pakujdesia nuk e ka ruajtur (në pamundësi për ta gjetur). Për këtë është interesuar dhe pranë firmës por nuk e kishin të ruajtur mandatet dhe nuk ka mundur ta sigurojë (tani të gjitha transaksionet i kryenin me bankë).*
- *Për mos-përputhjen e datës së tërheqjes dhe depozitimit të shumës 26.000 më datë 27.08.2015, në BKT dhe të deklaratës përpiluar më datë 29.08.2015 është bërë pasi nuk ndodhej administratori i shoqërisë “Ermir” atë ditë (me sa i kujtohet).*

125.2 Gjithashtu, subjekti ka dhënë të sqarime/shpjegime të njëjta edhe gjatë seancës dëgjimore i pyetur mbi këto konstatime të Trupës për vlerën 26.000 euro.

126. Në vitin 2019 është **porositur apartament pranë shoqërisë A***M, në shumën 44.000 euro dhe në vitin 2020, garazh me vlerë 6.000 euro**, me pagesa të kryera nga llogaria në BKT. Me revokimin e kontratave, në Dhjetor 2020, shuma 50.000 euro rikthehet në llogari, e cila nëpërmjet 4 transaksioneve shkon për pagesa të aseteve të deklaruara më sipër, konkretisht, vlera 34.000 euro për apartament dhe garazhet në vlerën 16.000 euro.

126.1 Për këto veprime të kryera, subjekti dha sqarime duke bashkëlidhur dokumentacion justifikues:

- a. Kontratë paraprake shitje nr. ****, datë 29.08.2019, me palë shitëse shoqëria “A****M” shpk dhe palë blerëse Lorenc Panganika. Midis shoqërisë A****M shpk dhe shoqëria investitore “K*** A****” shpk është lidhur kontrata e porosisë nr. ***/****, datë 22.08.2019.
- b. Kontratë porosie nr. ****/****, datë 22.08.2019, me investitor shoqëria “K****” shpk dhe porositësi shoqëria “A****M” shpk., ku investitori i shet apartamentin nr. 10, në katin e tretë, me sipërfaqe totale 100.54 m², në vlerën 65.000 euro, e cila është likuiduar midis palëve sipas faturave tatimore të lidhura mes tyre.
- c. Kontratë paraprake, shitje garazhi, nr. ****, datë 23.4.2020, me palë shitëse shoqëria “A***M” shpk dhe palë blerëse Lorenc Panganika, të garazhit kati i parë nëntokë, në kuotën -7.05, në vlerën 6.000 euro, e cila do të shlyhet nëpërmjet llogarisë bankare brenda dy ditëve.
- d. Kontratë porosie nr. ***/****, datë 23.04.2020, me investitor shoqëria K**** shpk dhe porositësi shoqëria “A****M” shpk., ku investitori i shet garazh në vlerën 6.000 euro.
- e. Revokim aktesh të tjera nr. ****, datë 30.10.2020, me deklarues “A****M” shpk dhe Lorenc Panganika, të cilët deklarojnë se revokojnë kontratat nr. ****, datë 29.08.2019 dhe nr. ***/****, datë 23.04.2020, me Objekt porositjen e një apartamenti me sipërfaqe totale 100.54 m² dhe një garazhi të ndodhur në katin -I nëntokë, në kuotën -7.05. Brenda një jave, shoqëria “A****M” shpk do të kthejë nëpërmjet llogarive bankare vlerën 44.000 euro të apartamentit dhe 6.000 euro për garazhin. Palët nuk kanë pretendime nga njëra tjetra.

127. **Në lidhje me transaksionin në llogarinë euro në BKT të bashkëshortes, ku është depozituar shuma 20.000 euro më datë 09.05.2012 dhe tërhequr në datë 18.05.2012 dhe 21.05.2012**, subjekti sqaroi Trupën e Vlerësimit se, është marrë hua me mirëbesim vetëm për disa ditë, një të njohuri të tyre, K. B., i cili ushtron aktivitetin e këmbimit valutor në qytetin e Elbasanit. Qëllimi i marrjes së kësaj huaje ka qenë për garanci bankare, pasi bashkëshortja Entela Panganika, aplikoi për marrjen e vizës kanadeze, ku krahas të ardhurave kërkohej edhe gjendje e tyre. Marrja borxh është bërë për arsye se kursimet familjare kanë qenë të investuar në Bono Thesari në Prill të vitit 2012, një pjesë ka qenë parapagim tek firma Ermir, një pjesë e kursimeve është dhënë vëllait të subjektit G.P.. *Ka përcjellë dokumentacion justifikues si vijon:*

127.1 Deklaratë noteriale nr. ***/***, datë 24.07.2023, me deklarues K. B., i cili deklaroi se ushtron veprimtari private në fushën e këmbimit valutor prej vitit 2000. Nga të ardhurat e tij, në Maj 2012 i ka dhënë me mirëbesim shtetases Entela Panganika, shumën 20.000 euro, për të përdorur si garanci bankare me qëllim aplikimin e vizës kanadeze. Shumën ia ka dhënë për një periudhë disa ditore të cilën e ka thyer në momentin e tërheqjes nga banka. Atëherë nuk ka mbajtur akt noterial për shkak të kohës së shkurtës që do të zgjaste depozitimi për shkak të pajisjes me vizë si dhe prej miqësisë familjare që ata kanë.

127.2 Ekstrakt historik i regjistrimit në QKB, për subjektin “Tilba”, me NIPT ****, më datë regjistrimi 16.06.2021, me administrator K. B., i cili zotëron dhe 50% të aksioneve të kësaj shoqërie. Formular i deklarimit të pagesës së tatimit mbi fitimin, të shoqërisë TILBA për periudhën 2003 – 2012. Nxjerrje llogari bankare të shoqërisë “Tilba” shpk, pranë BKT, për periudhën 01.04.2012 - 30.04.2012, ku, në datën 19.04.2012 është tërhequr shuma 13.990.000 lekë, nga K. B.

127.3 Nxjerrje llogari bankare të shoqërisë “Tilba” shpk, pranë BKT, për periudhën 01.05.2012 - 31.05.2012, ku, në datë 02.05.2012 janë kryer 2 tërheqje në shumën totale 14.000.000 lekë, nga K. B.

128. **Për sa i përket kreditimit në llogari në vitin 2011, në vlerën 27.000 Euro, nga shtetësja E. I.**, subjekti sqaroi se është kushërira e tij të cilën e ka autorizuar për të kryer veprime në bankë, meqënëse është punonjëse në BKT. *Paraqiti:*

- Nxjerrje llogari bankare, datë 13.06.2023, në BKT, në monedhën euro, në emër të Lorenc Panganika, ku, në datë 16.08.2011 është transferuar vlera 27.000 euro, nga E. I.
- Nxjerrje llogari bankare, datë 13.06.2023, në BKT në monedhën lekë, në emër të E. I., ku në datë 16.08.2011 është depozituar vlera 3.700.000 lekë nga Lorenc Panganika.
- Mandat arkëtimi datë 09.08.2011 nga Lorenc Panganika, i cili ka depozituar vlerën 3.700.000 lekë, në llogari të personelit të bankës E. I.

128.1 Në lidhje me qëllimin që ka depozituar në llogarinë e shtetases E. I., e cila pas 8 ditësh i ka kaluar në llogarinë e tij të konvertuara në 27.000 euro (rreth 560 euro më pak sesa kursi i këmbimit të kohës)², subjekti sqaroi se: “...është për të bërë konvertimin nga monedha Lekë në Valutë Euro. Duke qenë se kursi i këmbimit në atë periudhë ka qenë i lartë ka kryer këtë transaksion për të përfituar sa më shumë. Kjo është edhe arsyeja që e kam kryer këtë transaksion me shtetasen E. I. pasi është punonjëse banke me vjetërsi....”

128.2 Subjekti ka sqaruar gjithashtu se, duke qenë se shtetasen E. I. e ka kushërirë të parë (vajzën e motrës së babait) dhe është punonjëse në BKT, autorizimi është bërë në mirëbesim dhe jo në mënyrë formale me ndonjë akt noterial.

² Sipas kursit mesatar për muajin Gusht 2011 (3.700.000 lekë*0.007146) shuma e depozituar nga subjekti në llogarinë e E. I. e konvertuar në euro rezulton 26.440 Euro.

129. Në lidhje me revokimet e kontratave dhe mospasqyrimin e tyre në deklaratën e pasurisë, subjekti e ka kuptuar se duhet të deklaronte gjendjen faktike të pasurive të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete etj..
130. Subjekti ka dhënë shpjegime për transaksionet në emër të tij dhe bashkëshortes në BKT gjatë periudhës 2011 - 2023, duke paraqitur dokumentacion në lidhje me disa prej tyre konkretisht në lidhje me huadhënien/huamarrjet, si dhe revokimin e marrëveshjeve me shoqëritë "E***" dhe "A***M" shpk.
131. Për sa më sipër shpjeguar, subjekti dha të njëjtat sqarime edhe në seancën dëgjimore gjatë momentit të pyetjeve nga Trupa e Vlerësimit.
132. Banka Intesa Sanpaolo, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit FIBank, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Union, Banka OTP, Albania Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës AK – Invest, Easypay, Fondi BESA Institucioni Financiar NOA IUTECREDIT Albania Kredo Financë konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, ç'ka konfirmohet me deklarin.
133. Drejtoritë Vendore të ASHK-së, Librazhd, Korçë, Gjirokastrë, Fier Devoll, Krujë, Pogradec, Kukës Kavajë, Lushnjë, Kuçovë, Malësi e Madhe, Lezhë, Kolonjë, Bulqizë, Skrapar, Peqin, Tropojë, Përmet, Tepelenë, Mat, Sarandë, Vlorë, Shkodër, Kamëz, Vorë, Kurbin (me email), Dibër (me email), në përgjigjet e tyre, nuk konfirmojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
134. **QKB**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrarit tregtar.
135. **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Lorenc Panganika dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
136. Trupa e vlerësimit kreu analizën financiare mbi mundësinë për kursim nga të ardhurat familjare të subjektit të depozituara ndër vite në BKT, Tirana Bank, Credins Bank dhe Raiffeisen Bank, si dhe interesat bankare e gjeneruara prej tyre, të paraqitura në pasqyrën financiare të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për periudhën 1994-01.03.2023. **(Sipas tabelës financiare bashkëlidhur këtij vendimi)**
- Të ardhurat neto të subjektit për periudhën 1994 - Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 23.393.154 lekë.
 - Të ardhurat neto të bashkëshortes për periudhën Shtator 2004 — Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 11.213.265 lekë.
 - Të ardhurat nga interesat bankare, për periudhën 2015 - 01.03.2023, konfirmohen në vlerën rreth 4.370.725 lekë.

- Kredi marrë në RFZ Bank, në Vitin 2011, në vlerën 2.500.000 lekë. (principali i mbetur rreth 1.087.000 lekë).
- Dhuratë me rastin e lindjes së djalit në vitin 2012, në shumën 10,000 Cad nga të afërm të bashkëshortes në Kanada, e konvertuar rreth 1.090.000 lekë.
- Për periudhën 2000 - 01.03.2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 12.105.000 lekë. *(këtu marrë në konsideratë dhe uljen e shpenzimeve jetike për bashkëshorten dhe fëmijët, të cilët kanë qëndruar dhe janë ndihmuar nga familjarët e saj gjatë periudhës së punësimit të subjektit larg vendit të banimit.*
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për shërbime shëndetësore në vlerën 4.912 Cad, të konvertuar në vlerën rreth 535.000 lekë.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË:

137. Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktoritetit, u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti në seancën dëgjimore, ku arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- ✓ **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me Ligjin, me burimet e liqshme financiare;**
- ✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të liqshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

138. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

139. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- (i) *të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- (ii) *raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;*
- (iii) *verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërmra (ë), të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

140. Subjekti i vlerësimit, z. Lorenc Kristo Panganika, në zbatim të Nenit 36, pika 2 e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit,

Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 01.03.2023.

141. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:
- Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
 - Raportin e hollësishëm të përgatitur nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
142. Në përputhje me nenin 42 pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit raporti me Nr. *** Prot., datë 23.08.2023, i përpiluar me përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese, ku është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Lorenc Panganika.
143. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:
- 143.1 Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.
- 143.2 Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.
- 143.3 Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet
- 143.4 Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin
- 143.5 Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë, si më poshtë vijon:
- 1) Nuk është dënua ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
 - 2) Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj.
 - 3) Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepr penale.
 - 4) Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
 - 5) Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
 - 6) Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
 - 7) Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij të jetë i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
 - 8) Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
 - 9) Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
 - 10) Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

- 11) Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - 12) Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
 - 13) Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - 14) Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
 - 15) Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
 - 16) Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
 - 17) Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015, “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - 18) Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
 - 19) Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
 - 20) Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
144. Po ashtu, subjekti ka nëshkruar edhe dy vetëdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

HETIMI ADMINISTRATIV

145. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligjzbatuese, ku ka rezultuar si vijon:
146. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 01.06.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika.
147. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.*** Prot., datë 19.05.2023; për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.
148. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresat “Sekret”, Nr. ***Prot., datë 25.05.2023 dhe nr. ***, datë 27.03.2023, për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se disponon të dhëna për z. Panganika.

- Me shkresën nr. ***/*, datë 02.08.2023, ky institucion ka dhënë sqarime shtesë në lidhje me këto të dhëna, të cilat janë marrë në analizim.

149. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar” Nr. ***, datë 30.05.2023 dhe me shkresën “E paklasifikuar”, Nr.*** Prot., datë 30.05.2023; për subjektin e vlerësimit Lorenc Panganika, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk ka të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara nën pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar);
- Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk ka të dhëna nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- Nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS;
- Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.

150. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “Konfidencial”, Nr. *** Prot., datë 31.05.2023; për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

151. **Institucion ligjbatues** me shkresat “Sekret” datë 13.06.2023 dhe datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm.
- Nuk ka procedime penale të referuara.

151.1 Për subjektin e vlerësimit në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave janë regjistruar dy ankesa më datë 14.04.2021, ku dy shtetas kane ankimuar vendimin e Komisionit të Kontrollit Shëndetësor, në Komisionin e Apelit ngritur me Urdhërin nr. ***, datë

19.02.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku një ndër anëtarët ka qenë edhe punonjësi i policisë Drejtues i Parë Lorenc Panganika.

- ✓ **Komisioni i Apelimit pas verifikimit të procedurës së ndjekur dhe konsultimit në kuadrin ligjor, me Vendimet e datës 24.03.2021, në unanimitet ka vendosur mospranimin e ankimeve.**

167.2 Nga verifikimet e tjera rezulton se nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

152. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.*** Prot., datë 10.07.2023; për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Panganika, bën me dije se:

- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- d. Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- e. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. ***, datë 20.06.2023, bën me dije se janë regjistruar dy kallëzime penale, për të cilat është marrë vendim për mosfillim të procedimit.

153. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 07.06.2023; bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

154. **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, bën me dije se z. Lorenc Panganika është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret”, lëshuar më datë 21.09.2023, e vlefshme deri më datë 20.09.2028.

155. **Avokati i Popullit** me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. *** Prot, datë 30.05.2023; për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

156. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 08.06.2023; për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e vlerësimit rezulton se:

157. **Institucioni ligjzbatues**, në përgjigjen e datës 27.12.2023 drejtuar Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bën me dije se në emër të z. Lorenc Panganika nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
158. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. ***, datë 29.12.2023, bën me dije se shtetasi Lorenc Panganika rezulton pa shënime.
159. Subjekti i vlerësimit ka qenë i pajisur me Certifikatë të Sigurisë së Personelit, niveli “Tepër Sekret” deri më datë 30.05.2023. Gjatë periudhës që subjekti ka qenë në proces për t’u pajisur me CSP, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, bën me dije se nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP- së për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Panganika.
160. **Më datë 21.09.2023, Lorenc Panganika është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), të nivelit “Tepër Sekret”, e vlefshme deri më datë 20.09.2028.**

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

161. Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike, ku rezultoi se **nuk u zbulua** prania e produkteve të testuar.
162. Nga analizimi i materialeve që kanë lidhje me dy ankesat dhe dy vendimet e mos fillimit të hetimit, konstatohet se, dyshimet për përfshirjen e subjektit të vlerësimit Lorenc Panganika në veprimtari të kundërligjshme, në asnjërin prej rasteve të sipërpërmendura, nuk janë të vërtetuara dhe nuk qëndrojnë, e si rrjedhojë nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 42, pika 3, gërma “b”, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
163. Në përfundim të hetimit të kryer, për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Panganika dhe personale të lidhur me të, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar sipas nenit 35 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.
- Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - b. Raportin e përgatitur nga Policia e Shtetit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Panganika, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr. *** Prot, datë 30.06.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, në të cilin është konstatuar se:
- 3.3 Punonjësi i Policisë z. Lorenc Kristo Panganika është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme, duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

HETIMI ADMINISTRATIV

4. Subjekti i vlerësimit z. Lorenc Kristo Panganika, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, emëruar me urdhër nr. 2737/1, datë 16.12.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
5. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Subjekti i vlerësimit Lorenc Panganika, nga viti 2018 e deri aktualisht, ka qenë pjesë e Policisë së Shtetit.
6. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:
 - Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me nr. ****;
 - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS, me numër RMIS *****;
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuara nga vetë subjekti;
 - Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.
7. Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe performancës së konstatuar gjatë kontrolleve, inspektimeve apo ankesave në drejtim

të subjektit nga Drejtoria e Standarteve Profesionale apo institucioneve të tjera mbikëqyrëse.

Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:

1. Të dhëna për Arsimimin:

1986 – 1990: Arsim i Mesëm – Skolla e mesme Profesionale, Elbasan;
1990 – 1994: Arsim 3 vjeçar - Akademia e Rendit Publik, Tiranë;
1996 – 2003: Diplomë e Nivelit të Dytë, Fakulteti Drejtësisë, Tiranë;
2011 – 2013: Master profesional, Universiteti A. Xhuvani, Tiranë.

1.1 Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin 3-vjeçar në Akademinë e Rendit Publik, është pajisur me DND në Fakultetin e Drejtësisë dhe Master Profesional. Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, rezulton se:

✓ **Subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

2. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimeve dhe medaljet

2.1 Gjatë karrierës së tij, rezulton se subjekti i vlerësimit nuk ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

2.2 Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, të përcjella me Raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se ai ka kryer trajnimet dhe specializimet të cilat kanë shërbyer në formimin profesional të tij, si më poshtë vijon:

Nr.	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji dokumentit
1.	2002	Kurs “Këqyrja e vendit të ngjarjes dhe grumbullimit të provave”.	
2.	1996	Kurs 2-javor i SHIRI-T	Certifikatë
3.	2000	Kurs “Trajnimi i trajnerëve të policisë”	Certifikatë
4.	2001	Kurs “Menaxhimi i informacionit kriminal”	Certifikatë
5.	2001	Kursin e negociatave lidhur me peng marrjen	Certifikatë
6.	2004	Kurs trajnimi për formimin profesional të p.p. të rolit bazë	Certifikatë
7.	2005	Seminar “detyrat e policisë gjatë zgjedhjeve parlamentare 2005”	Certifikatë
8.	2008	Kurs trajnimi dhe vlerësimit të aftësive drejtuese	Certifikatë
9.	2008	Kurs për formimin e instruktorëve	Certifikatë

2.3 Nga verifikimi i të dhënave të administruara, rezulton se:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka kryer trajnime/specializime të ndryshme gjatë karrierës së tij në Policinë e Shtetit.**

3. Vlerësimet e punës

3.1 Nga dokumentacioni i dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit, për periudhën 2018-2022, janë administruar 3 (tre) vlerësime të aftësive individuale të punës (nga 5 (pesë) që duhej të ishin), si dhe bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar për punën e kryer, si vijon:

Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2017 - 31/12/2017	27 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2019 - 31/12/2019	“ska”	
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2020 - 31/12/2020	“ska”	
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2021 - 31/12/2021	27 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022	98 Pikë	(shumë mirë)

3.2 Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë se në periudhën 2019- 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

3.3 Nga kontrolli dhe verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, u konstatua se në Rubrikën II.3. “Vlerësimet e punës” të Raportit dhe vlerësimet e administruara në dosjen personale të subjektit, janë dërguar vetëm vlerësimet e punës për vitet 2017, 2021 dhe 2022. Për këtë arsye, DPPSH-së u është kërkuar informacion dhe dokumentacion mbi vlerësimin e rezultateve individuale të punës për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Nga përgjigja e kthyer Nr. *** Prot., datë 21.07.2023, rezulton se në dosjen e personelit nuk janë të administruara vlerësimet e punës për periudhën e kërkuar.

3.4 Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

3.5 Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga Trupa e Vlerësimit, konkludohet:

- ✓ **Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.**

4 Masat disiplinore

4.1 Referuar raportit të dërguar nga DPPSH, ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, si dhe nga verifikimi i Trupës së Vlerësimit në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018- 2022) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✓ **Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.**
- ✓ **Deklarimi i subjekti është i saktë.**

5 Ecuria në karrierë

5.1 Subjekti Lorenc Panganika ka një karriere në Policinë e Shtetit prej 29 vitesh. Nga verifikimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, subjekti Lorenc Panganika, ka ecurinë në karrierë, si vijon:

- 17.12.2022 – Aktualisht – Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier;
- 19.10.2021 – 16.12.2022 – Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë;
- 12.06.2020 - 18.10.2021 – Drejtor në Drejtorinë e Standardeve Profesionale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- 19.02.2018 - 11.06.2020 – Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë;
- 28.04.2017 - 18.02.2018 - Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë.

5.2 Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradat si me poshtë:

- Me Urdhrin Nr. ***, datë 09.12.2010, është ngritur në Gradën Drejtues, për periudhën 09.12.2010 – 06.04.2016.
- Me Urdhrin Nr. ***, datë 06.04.2016, është ngritur në Gradën Drejtues i Parë, për periudhën 07.04.2016 – aktualisht.

5.3 Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të z. Lorenc Kristo Panganika, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, Trupa e Vlerësimit konkludon se:

- ✓ **Funksionet në të cilat është emëruar subjekti, si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, liqjeve dhe akteve nënliqjore në fuqi.**

6 Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, seminare, botime brenda dhe jashtë vendit

6.1 Subjekti i vlerësimit, z. Lorenc Kristo Panganika, për periudhën e përcaktuar në formularin e aftësive profesionale, ka deklaruar se është angazhuar si vijon:

- Konferenca “Për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Gjyqësor”;
- Konferenca e parë ndërkombëtare “Kontributi për sigurinë publike nëpërmjet edukimit”;
- Konferenca shkencore “Depresioni dhe vetëvrasja në Shqipëri”;
- Konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare “Shkencat Ligjore”;
- Konferenca e katërt e Policive të Kryeqyteteve Evropiane: 26 - 28 Tetor 2022, Kosovë.

Në përfundim të hetimit të kryer për vlerësimin e aftësive profesionale;

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit Lorenc Panganika:

- ✓ ***Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;***
- ✓ ***Ka rezultuar i kualifikuar për të ushtruar atë funksion që mban;***
- ✓ ***Ka vlerësime pozitive pune.***

KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 19.04.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 02.05.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Lorenc Kristo Panganika, në përputhje me nenin 60 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. **Lorenc Kristo Panganika**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 02.05.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Erjana PJETRI

Kryesuese

Ersa KARAJ

Relatore

Klevis DHIGOI

Anëtar

	1994-2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	01.03.2023
A) PASURË		0	0	0	0	8,653,575	3,633,485	3,463,597	3,200,000	5,181,389	0	10,000,000	134,359	5,811,893	743,580	14,712,800	3,968,320	11,740,651
Apartment Eblsam, përfituar me dhurim v.2017																		
Apartment Eblsam, përfituar nga privatizim, zotëron 25% këq																		
Prenatim 2 jete parkimi v.2021 v1.6000 euro																	1,947,360	2,000,000
Prenatim Apartment Tirore v.2021 v1.50,887 euro						1,500,000											1,965,440	
Prenatim A.p. v1.4,000,000 Revokuar v.2017						3,562,000												
Prenatim A.p. Shog ENAMIS Revokuar v.2015																		
Prenatim A.p. Shog Arit2M Revokuar v.2020						91,575								5,467,950	743,580			
Bierje automjeti Fiat Punto, 13.12.2011																		
Bierje automjeti Opel Corsa, 14.05.2012																		
Bierje automjeti Daimlerchrysler 14.06.2012							339,867											
Bierje automjeti Daimlerchrysler 04.07.2013								66,561		181,389								
Bierje automjeti Fiat Punto, 18.09.2013																		
Bierje automjeti Daimler 210.05.10.2015													134,359	343,943				
Bierje automjeti Volkswagen Golf 26.10.2018																		
Bierje automjeti Volkswagen Tiguan 10.05.2019																		
Depozite BKT 22.05.2015												10,000,000				10,000,000		4,633,000
Obligacione 08.11.2017 Varte Nom 9,771,000 këq																		1,840,500
Obligacione 07.07.2021 v1.Nom 10,800,000																		
Obligacione 18.01.2023 v1.Nom 4,633,000																		
Obligacione 08.02.2023 v1.Nom 1,840,500																		
Pesemirje anahnd Bano 27.04.2012 Ark 1532								3,200,000										
Rinvestim ne anahnd 02.05.2013 Ark 1382																		
Rinvestim anahnd 01.05.2014 Ark 1635						3,700,000												
Depozitim cash ne llog. te E. Ekonom																		
Likuidite deklaruar E.P.																		4,724,338
B) DETYRIME		550,000	0	0	0	2,500,000	0	0	0	700,000	0	339,000	0	0	0	0	0	310,293
Kred 2007		550,000				2,500,000						339,000						0
Kred Bierje apartment 31.10.2011																		
Huamirje nga yehim P.M. (depozitim 22.08.2017																		
Kuar ndaluar L.P. nga llogarje e P.M.22.05.2015										700,000								
C) TEADURUA	5179,488	1,196,779	1,226,617	1,274,402	1,217,482	6,488,473	6,223,566	5,335,622	6,415,956	6,348,173	2,923,937	2,470,335	2,609,639	4,129,647	14,235,427	3,183,564	13,245,509	774,396
Te ardhura nga pagat shpirtërore subjekt L.P.	4,522,309	789,144	874,341	924,789	687,887	1,029,856	1,033,392	1,052,073	1,015,419	1,467,247	1,279,786	1,277,927	1,159,064	1,270,828	1,561,576	1,277,414	1,667,381	243,521
Te ardhura nga pagat shpirtërore bashkishtes E.P	657,160	407,635	352,276	349,613	354,795	238,617	409,694	574,078	593,315	566,210	641,376	772,213	867,701	807,345	776,548	971,786	276,669	25,500
Te ardhura nga pagat bashkishtes R.F.Z Bank																		
Te ardhura nga interesat e depozitës BKT 2015-2020 +v/nom										96,936	190,785	191,195	191,252	191,252	5,095,160	452,642	452,642	229,500
Te ardhura nga kupon 57 Ark32 + v1. nomiale													452,642	452,642	452,642	10,223,642		229,500
Te ardhura nga Kupon 107 Ark 023												229,000						
Khim fondesh nd-cale																		
Te ardhura nga interesat 2012 Ark 1532 + v1. Nomiale							3,417,540											
Te ardhura nga interesat 2013 Ark 1532 + v1. Nomiale																		
Te ardhura nga interesat 2014 Ark 1635 + v1. Nomiale								3,357,621										
Te ardhura nga shije e mjetit Fiat Punto 13.11.2015										100,000								
Te ardhura nga shije e mjetit Opel Corsa 12.10.2012							279,440											
Te ardhura nga shije e mjetit Daimlerchrysler 08.04.2014									419,940									
Te ardhura nga shije e mjetit Daimlerchrysler 23.08.2013								35,1850										
Te ardhura nga shije e mjetit Fiat Punto 30.09.2016																		
Te ardhura nga shije e mjetit Daimler 210.29.04.2016																		
Te ardhura nga shije e mjetit Volkswagen Golf 11.02.2019																		
Te ardhura nga shije e mjetit Volkswagen Tiguan 22.12.2019																		
Te ardhura nga Khim Borch - GP 2014 & 2015										1,100,000								
Dhurim nga famijaret në Kanada							1,093,300											
Khim te ardhura nga reuom kontate Alb-Gre shpk						1,500,000												
Khim te ardhura nga reuom kontate ERRIIR 26.000eur																		
Khim te ardhura nga reuom kontate ARIZIM 50,000eur																		
Khim te ardhura nga konfirmim euro Ekonom 27.000 eur						3,700,000												
D) SHPENZIME	1,351,872	247,288	332,385	565,224	965,224	1,251,585	1,393,890	460,090	1,042,643	1,004,347	1,098,539	1,598,697	1,117,503	1,313,693	1,167,606	1,130,526	1,106,398	156,773
Shpenzime jetore jetike sipas INSTAT																		
Shpenzime pajese krede principla 550,000+ interes v.2007	1,351,872	235,728	193,545	426,504	426,504	426,504	279,096	279,096	860,849	822,553	916,745	898,376	953,388	995,868	1,018,968	981,888	1,097,760	132,000
Shpenzime pajese krede principla + interes 2,500,000eur		11,560	138,720	138,720	138,720	138,720												
Shpenzime Khim Borch për P.M. 22.11.2017						15,150	181,794	181,794	181,794	181,794	181,794	370,321	164,115	317,825	148,638	148,638	148,638	24,773
Shpenzime Huadhenë G.P. para v.2013					400,000	400,000						330,000						
Shpenzime mjekesorilindje gjatë							535,000											
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit																		
E) MUNDËSI KURSIMI - Te ardhura detyrim shpenzime p-	3,827,597	5,327,088	6,221,440	6,590,618	7,177,876	6,061,420	7,245,600	8,676,735	10,850,048	11,712,485	13,537,883	4,748,521	6,166,318	3,170,378	15,484,618	2,814,855	11,025,645	-